



Republika e Shqipërisë
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

**DOGANA
CUSTOMS**

Libri Jeshil 2024

Prioritetet 2025





**DOGANA
CUSTOMS**

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Libri Jeshil 2024

Prioritetet 2025



Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

www.dogana.gov.al

Tel: +355 42 232 988 Cel: +355 684053453

Email: helpdesk.dpd@dogana.gov.al



Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjja Fushë Mëzez,
autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra “Pajtoni Bussines Center”, kati 5.

PËRMBAJTJA

I. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm	5
II. Misioni dhe Vizioni.....	7
III. Organigrama.....	8
IV. Zhvillimet Kryesore	9
V. Performanca e të ardhurave nga Doganat	49
VI. Zbatimi i ligjit.....	52
VI. 1 Lufta Kundër Kontrabandës	52
VI. 2 Lufta ndaj trafiqeve të paligjshme.....	55
VI. 3 Hetimi doganor.....	59
VI. 4 Inteligjenca doganore dhe shkëmbimi i informacionit	62
VI. 5 Monitorimi dhe Analiza Riskut.....	64
VI. 6 Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale	66
VI. 7 Kontrolli aposterior	66
VII. Departamenti Teknik.....	68
VII.1 Procedurat Doganore.....	68
VII.2 Inovacioni Teknologjik.....	70
VII.3 Origjina	72
VII.4 Laboratori Doganor.....	73
VIII. Akciza	74
VIII. 1 Kontrolli i Akcizës	74
VIII. 2 Drejtoria Teknike e Akcizës.....	76
IX. Marrëdhëniet Ndërkombëtare	78
IX.1 Integrimi europian.....	83
IX.2 Bashkëpunimi me partnerët.....	85
X. Rritja e Kapaciteteve Administrative	86
XI. Prioritetet 2025	93
XII. Kontaktet	95

LISTA E SHKURTIMEVE

BE:	Bashkimi Europian
CEFTA:	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore
FMN:	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FIAA:	Shoqata e Investitorëve të Huaj
OBD:	Organizata Botërore e Doganës
AEO:	Operatori Ekonomik i Autorizuar
HMRC:	Agjencia Britanike e të Ardhurave dhe Doganave
HOIO:	Operacionet Ndërkombëtare të Ministrisë së Brendshme Britanike
AKU:	Agjencia Kombëtare e Ushqimit
PEN-CP:	Inovacion për Administratën Doganore
BB:	Banka Botërore
DHAT:	Dhoma Amerikane e Tregtisë
UNDP:	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNCTAD:	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
UNCODC:	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
BKH:	Byroja Kombëtare e Hetimit
ITMS:	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave
SEED:	Shkëmbimi Sistematik i të dhënave Elektronike
EAD:	Dokumenti Shoqërues i Eksportit
MCEN:	Rrjeti i Ndërmarrjeve të Trupave Detare



I. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Z. Genti Gazheli

Viti 2024 ishte sfidues për Doganat Shqiptare, por sërish një vit i suksesshëm përtej realizimit të të ardhurave në rreth 2.3 miliardë euro, ose rreth 125 milionë euro më shumë se viti 2023.

Ky rezultat, shumë më tepër se sa për t'u kënaqur, vlen për të inkurajuar Administratën Doganore se punë më e madhe na pret për vitin 2025 kur tashmë jemi përfshirë intensivisht në procesin e integritimit europian, në pozicionin negociues të Grup-Kapitullit 3, "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse".

Digjitalizimi i shërbimeve doganore, lehtësimit i tregtisë së ndershme, shërbimi ndaj biznesit, mbrojtja e interesave financiare të vendit, lufta ndaj kontrabandës dhe evazionit, ishin shtyllat kryesore që shënuan performancën e Doganave Shqiptare për vitin 2024.

Në kuadër të lehtësimit të tregtisë së ligjshme, duke ruajtur edhe kontrollin bazuar në risk të qarkullimit të mallrave, mjeteve të transportit, apo personave, gjatë vitit 2024 është punuar në drejtim të rritjes së numrit të subjekteve në Kanalin Jeshil dhe reduktimin e kohës së procesimit të deklaratave edhe në Kanalin e Kuq, ku realizohet kontrolli fizik, si dhe kanalin e verdhë, ku realizohet kontrolli dokumentar.

Thjeshtimi dhe digjitalizimi i procedurave doganore kanë dhënë rezultate konkrete në drejtim të uljes së kohës mesatare të shqyrtimit të aplikimeve online nëpërmjet e-Albania. Gjatë vitit 2024 u shtuan dhe 5 Operatorë Ekonomikë të Autorizuar, duke e çuar në 16 numrin e AEO në total, ndërkohë që janë në shqyrtim dhe shumë kërkesa të tjera për të përfituar këtë status.

Fokusi ynë ka qenë dhe mbetet tek zhvillimet e Teknologjisë së Informacionit dhe në bashkëpunim me AKSHI-n dhe UNCTAD që ofron sistemin Asycuda Word, kemi modernizuar dhe digjitalizuar 100 për qind të shërbimeve doganore.


Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë në funksion të lehtësimit të tregtisë, pasqyruar gjerësisht në këtë botim, tregon stadin ku ka arritur performanca dhe besueshmëria e Administratës Doganore për institucionet ndërkombëtare, si: BE, OBD, CEFTA, FMN e BB, por dhe administratat homologe, sidomos të Italisë dhe vendeve të tjera kufitare, në përmbushjen e misionit tonë si një administratë efikase dhe transparente në realizimin e misioneve të saj.

Për vitin 2025 jemi në rrugën e duhur drejt një stadi më të lartë të standarteve të Administratës Doganore Shqiptare, në misionin e saj për t'iu shërbyer qytetarëve dhe biznesit, për të lehtësuar eksportet dhe importet, 100% shërbime digjitale, analizë risku mbështetur nga programe të Inteligjencës Artificiale, lehtësi për eksportues të

miratuar, deklarues të drejtëpëdrejtë dhe Operatorë Ekonomikë të Autorizuar, shërbim profesional dhe etik për biznesin dhe shtetasit shqiptarë e të huaj në secilën nga 18 degët doganore në të gjithë Shqipërinë.

Veprimtaria e Administratës Doganore do të mbështetet në tre objektiva kryesorë për vitin 2025: Efiçensë, Siguri dhe Prosperitet në rrugën e integritit drejt Unionit Doganor European.

Misioni



Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar dhe për këtë qëllim autoritetet doganore synojnë mbrojtjen e interesave financiare dhe mjedisore të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit, garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera, mbajtjen e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.



Doganat shqiptare, për përmbushjen e Misionit të saj, përcaktojnë parimet strategjike si më poshtë:

Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiare të Republikës së Shqipërisë;

Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare;


Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme;

Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave;

Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit;

III. Organizimi

Tabela 1: Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave



IV. Zhvillimet kryesore

Janar 2024

Bashkëpunim mes Doganës Shqiptare, Doganës Italiane dhe Guardia di Finanza

Drejtori i Administratës Doganore Shqiptare Genti Gazheli gjatë një vizite zyrtare në Romë, u takua me Drejtorin e Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve, Roberto Alesse dhe Komandantin e Përgjithshëm të Guardia di Finanza, Andrea De Gennaro, me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në çështjet e doganave.



Në vazhden e aktiviteteve të nisura me marrëveshjet dypalëshe për ndihmën e ndërsjellë, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin administrativ, u vendos të intensifikohen më tej përpjekjet e përbashkëta për të garantuar ligjshmërinë dhe sigurinë në aktivitetet tregtare ndërkufitare.

Tre administratat gjithashtu kanë rënë dakord të fillojnë shkëmbimin e përvojave dhe aktiviteteve të përbashkëta midis porteve të Ankonës, Barit dhe Brindizit dhe ato shqiptare të Durrësit dhe Vlorës. Këto nisma do të financhen edhe falë fondeve të Zyrës Europiane Kundër Mashtrimit, (OLAF) në kuadër të programit të unionit Adriacustoms.

Vizitë zyrtare në selinë e Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza

Në vijim të takimeve me Drejtorin e Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve Roberto Alesse dhe Komandantin e Përgjithshëm të Guardia di Finanza Andrea De Gennaro, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli u prit në një vizitë zyrtare në selinë e Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza. Kjo është vizita e parë e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave pranë Guardia di Finanza dhe Z. Gazheli vlerësoi si shumë të rëndësishme asistencën e Guardia di Finanza kryesisht në luftën kundër trafiqeve dhe kontrabandës.



Mes drejtuesve të institucioneve u ra dakord për nënshkrimin së shpejti të një Memorandumi Mirëkuptimi për bashkëpunimin me qëllim:

- (I) parandalimin e tregtisë së paligjshme kryesisht në rrugë detare,
- (II) shkëmbimin e informacioneve mes dy institucioneve në funksion të analizës së riskut,
- (III) trajnimin e stafit të Doganës Shqiptare pranë Akademisë së Guardia di Finanza.



Bashkëpunimi mes autoriteteve shqiptare dhe italiane në fushën e doganave merr një rëndësi të veçantë pasi Italia është partneri kryesor i Shqipërisë me një volum tregtar në vlerën e rreth 3.5 miliardë euro në vit nga të cilat rreth 1.73 miliardë euro janë eksportet dhe 1.77 miliardë euro importet.

Bashkëpunimi mes Drejtorisë së Doganave dhe Dhomës Amerikane të Biznesit

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Shoqatës së Sektorit Manufakturë të Veshjeve dhe të Këpucëve.

Takimi i Presidentit të Dhomës Grant Van Cleve dhe Drejtorit Ekzekutiv Neritan Mullaj me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave Genti Gazheli është hapi i parë i ndërmarrë në vitin 2024 nga drejtuesit e dy institucioneve për të konsoliduar marrëdhëniet e punës në funksion të shërbimit ndaj biznesit. Dhoma Amerikane ka një histori të gjatë të takimeve periodike me Drejtorinë e Doganave dhe ka ndërtuar një platformë të drejtëpërdrejtë komunikimi në trajtimin e çështjeve që anëtarët e saj hasin në dogana.

Kjo është reflektuar në vlerësimin pozitiv që anëtarët e Dhomës Amerikane i kanë dhënë marrëdhënieve me Doganat në Indeksin e Biznesit, duke dëshmuar efektivitetin e ndërtimit të urave të bashkëpunimit mes biznesit dhe institucioneve.



Për të forcuar këtë marrëdhënie, drejtuesit e AmCham dhe Doganave, kanë folur konkretisht për planet e bashkëpunimit gjatë vitit dhe format më të mira të trajtimit të çështjeve "ad hoc", apo ato që janë në proces. Vijimi i lehtësimit të procedurave doganore, apo proceset e digjitalizimit të sistemeve, mbeten tema dypalëshe për të cilat është e nevojshme shkëmbimi i informacionit dhe diskutimi mbi zgjidhjet e propozuara.

Drejtuesit e të dy institucioneve e vlerësuan si mjaft të rëndësishëm promovimin e statusit OEA (Operatori Ekonomik i Autorizuar) dhe inkurajimin e biznesit për të aplikuar për këtë status që lehtëson dhe shkurton kohën procedurave në dogana.

Dhoma Amerikane është e vetëdijshme se doganat janë porta hyrëse e biznesit në tregun vendas dhe për rrjedhojë dhe impresioni i parë që biznesi lokal, por dhe investitorët e huaj marrin për standartin e klimës së biznesit në vend. Në funksion të këtij qëllimi Dhoma Amerikane do të vijojë të nxisë këto bashkëpunime dhe marrëdhënie që prodhojnë siguri dhe qartësi për biznesin.

Shkurt 2024

Takim me ekspertët e misionit të TAIEX

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli priti në një takim misionin e ekspertëve të TAIEX, (financuar nga Bashkimi Europian) përbërë nga Z. Boris Kastelic, Drejtor i Departamentit të Doganave dhe Z. Branko Gregorič, Koordinator i Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Financave të Sllovenisë.

Qëllimi i këtij misioni është të ndihmojë Administratën Doganore Shqiptare në përgatitjen e Planit të Veprimit të “Strategjisë së Biznesit të Doganave 2023-2027”, e hartuar gjithashtu me asistencën e Bashkimit Europian, me qëllim modernizimin e Administratës Doganore në funksion të lehtësimit të tregtisë.



Në fjalën e tij Z. Gazheli u shpreh se Doganat u vlerësuan maksimalisht nga Komisioni Europian në procesin “screening” dhe se prioritetet kryesore të Administratës Doganore për katër vitet e ardhshme janë: digjitalizimi (sistemet e teknologjisë së informacionit dhe Inteligjencës Artificiale në vlerësimin e riskut) dhe forcimi i kapaciteteve administrative në procesin drejt një dogane moderne, sipas standardeve të BE-së.

Ekspertët e TAIEX-i vlerësuan progresin e Shqipërisë në procesin e integritit kryesisht për Kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”, si dhe theksuan se Administrata Doganore Shqiptare duhet t’i përshtatet sfidave të bashkimit doganor me BE-në sipas praktikave më të mira.

 Mars 2024**Takim me Drejtorin e SELEC**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, priti Drejtorin e Përgjithshëm të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore (SELEC), Oğuz Serkant Akin.



Në fokus të këtij takimi ishte bashkëpunimi i mëtejshëm i Administratës Doganore Shqiptare me organizatën ligjzbatuese SELEC, në kuadër të luftës kundër kimit të organizuar ndërkufitar, si dhe në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës kriminale.

Dy drejtuesit e institucioneve diskutuan edhe në lidhje me koordinimin e hetimeve të përbashkëta, si dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mes 11 shteteve anëtare të SELEC.

Në kuadër të aktiviteteve operacionale të SELEC, Shqipëria, e cila drejton Task-Forcën Anti-Mashtrim dhe Anti-Kontrabandë, ka koordinuar deri më tani 4 operacione rajonale: Operacioni Eclipse, Operacioni Know-How, Operacioni Eclipse II dhe Operacioni Know-How II.

Takimi me drejtues të UNCTAD



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli zhvilloi një takim me drejtues të Programit Asycuda të UNCTAD, Z. Fabrice Millet, drejtues i Programit, Z. Dmitry Godunov, koordinator rajonal, Z. John David, drejtor i zhvillimit të programit dhe Z. Constantin Ciuta, menaxher zyre i programit Asycuda.

Drejtori i Përgjithshëm Z. Gazheli, shprehu vullnetin e Administratës Doganore Shqiptare për zhvillime të reja të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të sistemit informatik doganor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian që përfshijnë tranzitin komunitar, vendimet doganore dhe deklarimin e thjeshtuar.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nënvizoi rolin e zhvillimeve të teknologjisë së informacionit për uljen e kohës së procedurave doganore për biznesin dhe individët, duke nxitur ndërveprimet me institucionet e tjera, si Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Postën Shqiptare, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor etj.

Drejtuesit e UNCTAD shprehën gatishmërinë dhe vullnetin në mbështetje të kërkesave të ADSH me qëllim modernizimin e sistemit informatik doganor në përputhje me standardet e BE-së.

Lufta kundër trafikëve e kontrabandës me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Gent Gazheli, u takua me Drejtorin e Përgjithshëm për Zbatimin e Emigracionit në Ministrinë e Brendshme britanike, Bas Javid.



Në takim u diskutua mbi masat e ndërmarra nga Shqipëria në luftën kundër trafikëve e kontrabandës dhe mbështetjen nga Mbretëria e Bashkuar ndaj Shqipërisë.

Prill 2024

Memorandum Bashkëpunimi mes Administratave Doganore të Shqipërisë, Italisë dhe Guardia di Finanza

Me ftesë të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve të Italisë, Roberto Alesse dhe Komandanti i Përgjithshëm i Guardia di Finanza, Andrea De Gennaro, zhvilluan një vizitë zyrtare në Tiranë. Kjo është vizita e parë e njëkohëshme pranë Doganave Shqiptare e dy drejtuesve të lartë të Doganave dhe fiskut italian. Gjatë takimit të përbashkët mes tre drejtuesve të institucioneve financiare u diskutua në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Administratave Doganore të Italisë, Shqipërisë, dhe Guardia di Finanza ku u ritheksua nevoja për forcimin e marrëdhënieve trepalëshe ndërmjet institucioneve.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Monopoleve Italiane, Roberto Alesse, Komandanti i Përgjithshëm i Guardia di Finanza, Andrea De Gennaro dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare, Genti Gazheli, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për ngritjen e një Komisioni të Përbashkët Doganor Italo-Shqiptar, si një instrument për forcimin e lidhjeve, bashkëpunimin trepalësh dhe lehtësimin e dialogut ndërmjet Guardia di Finanza-s dhe Administratave Doganore të Italisë dhe Shqipërisë.

Komisioni, i cili bashkëkryesohet nga Drejtori i Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve, Roberto Alesse, Komandanti i Përgjithshëm i Guardia di Finanza, Andrea De Gennaro dhe Drejtori i Administratës Doganore Shqiptare, Gent Gazheli, do të kryejë monitorimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratave Doganore të Italisë dhe Shqipërisë dhe ndërrmarjen e nismave të përbashkëta, si:

- a) nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit;
- b) lehtësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit për të luftuar kontrabandën, mashtrimin dhe aktivitete të tjera të paligjshme që lidhen me tregtinë ndërkombëtare;
- c) zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta për të rritur aftësitë operacionale dhe teknologjike;
- d) nxitjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë për rregulloret doganore në fuqi për shtetet pjesëmarrëse dhe marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse.

Takimi vjetor i rajoneve të ECA për mbrojtjen e shtresës së Ozonit

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori pjesë në takimin teknik vjetor për rajonin e Europës dhe Azisë mbi Zbatimin e Protokollit të Montrealit për mbrojtjen e shtresës së Ozonit, organizuar në Tiranë nga Programi i Mjedisit të Kombeve të Bashkuara (UNEP) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë.



Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim ai u shpreh se, Shqipëria ka në zbatim një bazë të plotë ligjore të Protokollit të Montrealit. Nga ana tjetër Gazheli tha se në sistemin doganor janë krijuar dhe përditësohen rregullisht profilet e riskut për substancat ozonholluese, si dhe për produktet dhe pajisjet që i përmbajnë ato, me qëllim zbatimin e ndalimeve dhe kufizimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunon me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njësinë Kombëtare të Ozonit për përmirësimin e cilësisë së kontrolleve nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe sigurimin e pajisjeve funksionale për identifikimin e substancave ozonholluese.

Po ashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim edhe me Njësinë Kombëtare të Ozonit, zhvillon trajnime të përvitshme për personelin doganor mbi detektimin e substancave ozonholluese dhe përdorimin e pajisjeve identifikuese të këtyre substancave.

Vizitë në Portin MBM në Porto Romano

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një vizitë në Portin MBM në Porto Romano, Durrës.



Rritja me 35% e kapaciteteve përpunuese në harkun kohor të një viti, reduktimi i kohës së përpunimit të mjeteve lundruese dhe plotësimi i kushteve teknike e ka kthyer Portin MBM në Porto Romano në një pikë orientimi për të gjithë tregun rajonal në vetëm 3 vite aktivitet, duke konkurruar portet në mbarë rajonin.

MBM Port është porti më i madh i karburanteve në Shqipëri. Ai ka një kapacitet që furnizon si tregun shqiptar ashtu edhe atë të vendeve fqinje. Zona e Lirë Portuale e Porto Romanos përfshin një terminal në zonën e portit si dhe hapësirën e depozitave të hidrokarbureve. Ajo ka një infrastrukturë moderne për transferimin e Produkteve të Naftës dhe LPG nga porti në depozitat e stokimit. Ajo ka një rekord prej 1.2 milion ton të transferuara në vit.

Vizitë në Portin e Durrësit

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në Portin e Durrësit, ku me afrimin e sezonit turistik kërkohet një energjizim i gjithë strukturave pritëse dhe veçanërisht atyre të Doganës. Korrektësia, integriteti dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e tjera ligjzbatuese që operojnë në Portin e Durrësit, si porti më i madh në vend, ishte mesazhi kryesor që ai u dha punonjësve të Administratës Doganore.



Me vënien në funksion të sistemit operativ online Navis 4, ofrohet një standard i ri pune në fushën e përpunimit të kontejnerëve në Portin e Durrësit, duke sjellë rritjen me 45% të volumit të mallrave të përpunuara. Mbi 827 mijë pasagjerë dhe 96,429 automjete kanë udhëtuar nga/drejt Portit të Durrësit përgjatë vitit 2023.

Konferenca e Organizatës Botërore të Doganave

Me ftesë të Organizatës Botërore të Doganave, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori pjesë në Konferencën Rajonale të Drejtorëve të Doganave në selinë e OBD-së në Bruksel.



Sekretari i ri i Përgjithshëm i OBD-së, z. Ian Saunders, prezantoi "Draft-Planin e modernizimit të OBD-së", që parashikon forcimin e dimensionit rajonal të OBD-së nëpërmjet zhvillimit të kuadrit për entitetet rajonale dhe formalizimit të qasjes për strukturat rajonale dhe organet e njohura të OBD-së.

Plani i Modernizimit të OBD-së mbështetet në një set indikatorësh të matshëm dhe konkretë që i përgjigjen sfidave të Administratave Doganore në drejtim të lehtësimit të tregtisë së ligjshme, mbledhjes së të ardhurave, parimit të mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiare të vendit, si dhe zhvillimin institucional.

Anëtarët e rajonit të OBD Europë të drejtuar nga Norvegjia, diskutuan progresin e bërë në zhvillimin e planit dhe dhanë mbështetjen dhe udhëzimet e tyre për përmirësimin e bashkëpunimit në dimensionin rajonal të OBD-së.

Maj 2024

Takim me drejtorin e Doganave të Malit të Zi

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli u takua në Shkodër me drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Malit të Zi, Vladimir Bulajić. Dy drejtuesit e administratave doganore u ndalën në pikat doganore të Hanit të Hotit dhe Muriqanit, dy prej portave kryesore të hyrje-daljeve të qytetarëve shqiptarë dhe malazezë.




Gjatë takimit të përbashkët të dy delegacioneve u diskutua për rritjen e bashkëpunimit mes doganave tona, të cilat me afrimin e sezonit turistik shtojnë fluksin e udhëtarëve në dy anët e kufirit. Të dyja palët ranë dakord për lehtësimin e procedurave me qëllim reduktimin e kohës së qëndrimit të udhëtarëve dhe përpunimit të mallrave.

Doganat marin vlerësimet maksimale nga biznesi

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka marrë vlerësimet maksimale në Pyetësin e dytë të zhvilluar në funksion të rritjes së transparencës dhe në vijim të punës për përmirësimin e shërbimeve doganore ndaj biznesit.

Më shumë se 56% e bizneseve përgjigjen se aplikimet shqyrtohen shumë shpejt dhe mbi 75% e përgjigjeve nënvizojnë se procedurat e deklarimit, verifikimit fizik dhe vlerësimi zgjasin më pak se vitin e kaluar.



Në tërësi vlerësimi për përmirësimet që janë realizuar në procedurat doganore ka marrë përgjigje pozitive nga 87.5% e të anketuarve dhe mbi 60% e tyre vlerësojnë si “shumë të mirë” marrëdhënien me doganën, ndërsa 32.6% e vlerësojnë “mirë”.

Edhe shërbimet online kanë marrë vlerësimet maksimale nga biznesi dhe procesimi i deklarave të eksportit dhe importit është vlerësuar 55.9% “shumë i shpejtë” dhe 40.1% “mesatar”.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave po vlerëson me rigorozitet të gjitha sugjerimet e biznesit në funksion të perfeksionimit të shërbimeve të saj drejt standardeve të doganave të Bashkimit Europian.

Drejtoria e Doganave në sesionin e Këshillit të SELEC

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mori pjesë në sesionin e 24-të të Këshillit të SELEC (Southeast European Law Enforcement Center) që u mbajt më 30 maj 2024 në selinë e SELEC në Bukuresht, Rumania. Në këtë sesion morën pjesë anëtarë të Këshillit nga të gjitha shtetet anëtare të SELEC, Partnerëve Operacionalë, Vëzhguesve, si dhe Menaxhmentit të SELEC, Oficerëve Ndërlidhës dhe anëtarët e Shtabit.



Një temë e rëndësishme në rendin e ditës së seancës ishte kërkesa e Byrosë Kombëtare të Hetimit të Shqipërisë për t'u bërë Partner Operacional i SELEC, kërkesë e cila u miratua nga Këshilli. Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SELEC, i përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë të Shteteve Anëtare të SELEC.

Qershor 2024

Vizitë studimore në Institutin Poligrafik Zecca Dello Stato, Romë

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Administratave Doganore të Shqipërisë, Italisë dhe Guardia di Finanza, firmosur në Tiranë më 4 Prill 2024 dhe në vijim të zbatimit të planit të veprimit të ndërsjellë, një delegacion i nivelit të lartë i Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlera zhvilloi një vizitë studimore tek Instituti Poligrafik Zecca dello Stato në Romë.



Ky Institut, në varësi të Ministrisë së Financave të Italisë, është një strukturë e fuqishme, protagoniste e inovacionit digjital që dizajnon dhe prodhon letrat me vlerë për shtetin italian.

Arsyeja e kësaj vizite është vendosja e urave të bashkëpunimit ndërinstitucional me këtë Institut, pasi duke filluar nga data 1 Janar 2025, pulla fiskale si letër me vlerë dhe monopol shtetëror prodhohet dhe shpërndahet nga një subjekt i autorizuar nga Këshilli i Ministrave, një eksperiencë e ngjashme me atë të Italisë.

Takimi i tretë brenda vitit me homologun italian të doganave

Në vijim të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Administratave Doganore të Shqipërisë, Italisë dhe Guardia di Finanza, firmosur në Tiranë më 4 Prill 2024, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me drejtorin e Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve Italiane, Roberto Alesse.

Në këtë takim, i treti midis tyre brenda vitit, dy Drejtorët e Përgjithshëm ritheksuan rëndësinë e intensifikimit të marrëdhënieve midis dy administratave doganore, në mënyrë të veçantë asistencën teknike në fushën e akcizës.

Në takim morën pjesë edhe Drejtori i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të ADM, Andrea Mazzella dhe Drejtori i Drejtorisë së Akcizave të ADM, Luigi Liberatore.



Memorandumi “Mbi krijimin e Observatorit të Logjistikës Detare dhe Zinxhirëve të Furnizimit”

Nën kujdesin e veçantë të zv/kryeministres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj. Belinda Balluku, u nënshkrua në Durrës Memorandumi “Mbi krijimin e Observatorit të Logjistikës Detare dhe Zinxhirëve të Furnizimit”. Observatori do të shërbejë si një platformë ndërinstitucionale digjitale për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave mbi logjistikën detare dhe zinxhirët e furnizimit në Shqipëri. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Memorandumi u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Genti Gazheli.



Sipas Memorandumit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anagazhohet të furnizojë me të dhëna statistikore mbi vëllimet tregtare të mallrave të importuara/eksportuara/tranzitit përmes porteve shqiptare, si dhe të ndihmojë në identifikimin e vendeve të origjinës dhe


destinacionit, vlerës dhe të dhëna të tjera publike dhe të dobishme për qëllimet studimore të observatorit.

Anketa e Indeksit të Biznesit të Dhomës Amerikane të Tregtisë

Dhoma Amerikane e Tregtisë publikoi Anketën e Indeksit të Biznesit ku marrëdhëniet me Administratën Doganore janë në nivelet më të larta krahasuar me institucionet e tjera. Sipas sondazhit me anëtarët e AmCham, marrëdhëniet me Doganat janë përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme tre vitet e fundit, duke arritur në nivelin më të lartë, rreth 64.4%, ndërkohë që indeksi mesatar shënoi rreth 47.6 për qind.

3.4.2 Relation with Customs Authorities


How was the relation of your business with the customs authorities for the last year (2023)?



Presidenti i AmCham, Grant Van Cleve, e vlerësoi si shumë pozitiv bashkëpunimin me Administratën Doganore në funksion të përmirësimit të klimës për biznes në Shqipëri. Për vitin e fundit është rritur me 6.6 për qind numri i bizneseve që vlerësojnë si mjaft të mira marrëdhëniet me Administratën Doganore.

Relation with Customs Authorities

*A higher score is better.



Korrik 2024

Vizitë në Doganën e Vlorës

Me hyrjen në pikun e sezonit, stafi i Degës Doganore Vlorë është vënë në shërbim 24/7, duke përballuar me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm numrin e madh të mjeteve dhe pasagjerëve në këtë portë të rëndësishme për turizmin në vendin tonë.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, vizitoi nga afër Degën Doganore Vlorë, ku falenderoi stafin për përkushtimin profesional gjatë këtij sezoni të ngarkuar, ndërsa kërkoi që mikpritja dhe përgjegjësia profesionale të jenë kryefjala e çdo punonjësi të administratës doganore.

Vizitë në Doganën e Muriqanit

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në pikën doganore të Muriqanit, ku pa nga afër punën e punonjësve të kësaj dogane në zemër të sezonit turistik. Duke i shprehur mirënjohjen stafit për profesionalizmin në përballimin e fluksit të lartë të vizitorëve, ai ka kërkuar shërbim sa më mikpritës gjatë ditëve me temperatura të larta.



Në pikën doganore të Muriqanit gjatë sezonit turistik, vetëm në 24 orë kanë kaluar 17587 qytetarë si dhe 5263 mjete.

Vizitë në Doganën e Hanit të Hotit

Drejtori i Doganave, Genti Gazheli vizitoi dhe Doganën e Hanit të Hotit, e cila ashtu si çdo pikë tjetër doganore në vend përballlet me një fluks të madh lëvizjesh të qytetarëve në të dy anët e kufirit gjatë sezonit turistik.



Ai falenderoi punonjësit që e përballojnë me mjaft profesionalizëm ritmin e punës në pikun e sezonit, duke u shërbyer 24/24 qytetarëve dhe pushuesve që kalojnë përmes kësaj pike doganore.

Gusht 2024

Porti i Durrësit, një ndër pikat kryesore hyrëse të turistëve këtë sezon veror ka regjistruar shifra rekord. Mbi 85 mijë qytetarë kanë mbërritur në këtë Port përmes porteve italiane vetëm gjatë muajit korrik.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli ishte në Portin e Durrësit, ku vetëm fundjavën e parë të gushtit mbërritën rreth 15000 pasagjerë.



Aeroporti ndërkombëtar Nënë Tereza gjatë muajit gusht të këtij viti ka kryer mesatarisht 240 fluturime në 24 orë, ndërsa numri i udhëtarëve arriti në mbi 40 000 mijë në ditë.



Gjatë muajit korrik aeroporti i Rinasit priti 1.2 milion pasagjerë.

Vizitë në Porto Romano

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli së bashku me ministrin e Financave, Z. Petrit Malaj zhvilluan një vizitë në ambientet e portit të karburanteve në Porto Romano, për të parë nga afër zbatimin e Planit operacional mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për kontrollin e veprimtarisë së importit, eksportit, prodhimit, depozitimit, transportimit dhe tregtimit të hidrokarbureve.



Plani i përbashkët operacional ka synim kontrollin dhe monitorimin e importit, mbajtjes dhe tregtimit të produkteve energjetike të akcizës për zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi. Po ashtu ai synon identifikimin e individëve, personave fizikë apo juridikë që zhvillojnë në mënyrë të jashtëligjshme aktivitetin e importimit, mbajtjes, tregtimit të produkteve energjetike të akcizës; rritjen e forcës goditëse dhe ndjekjen penale të individëve, personave fizike, juridikë që zhvillojnë në mënyrë të jashtëligjshme aktivitetin e importimit, mbajtjes, tregtimit të produkteve energjetike të akcizës; sekuestrimin e produkteve energjetike të akcizës të pafiskalizuara, apo që nuk plotësojnë standardin e cilësisë, si dhe parandalimin e kontrabandimit, apo deklarimeve të rreme të produkteve energjetike të akcizës.



Për periudhën 7 mujore 2024 konsumi i karburanteve arriti në 381,083 tonë me rritje 19,700 tonë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 kur konsumi ishte 361,381 tonë.

Vizitë në Doganën e Morinës

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një vizitë në degën doganore të Morinës. Gjatë takimit me punonjësit e kësaj dogane, ai falenderoi stafin për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në përballimin e fluksit të udhëtarëve që këtë sezon turistik ka arritur kulmin, me mbi 4.5 milionë qytetarë dhe afro 1.4 milionë mjete që kanë kaluar kufirin nga muaji Qershor deri në fund të Gushtit.



Drejtori Gazheli kërkoi përgjegjshmëri, vëmendje të shtuar dhe etikë profesionale nga çdo punonjës i Administratës Doganore në përballje me qytetarët dhe angazhim maksimal gjatë muajve të fluksit të udhëtarëve.

■ Shtator 2024

Punonjësit e Doganës trajnim “Mbi kontrollin e anijeve”

Në kuadër të asistencës së doganave franceze për Administratën Doganore Shqiptare nisi në ambientet e Komandës së Guardia di Finanza-s në Durrës trajnimi i punonjësve të Doganës Shqiptare “Mbi kontrollin e anijeve”.

Në ceremoninë çelëse të këtij trajnimi ishte i pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, Atashehu Doganor Francez, Christophe Bergeon, si dhe Atashehu i Guardia di Finanza-s pranë ambasadës italiane në Tiranë, Gianpiero Carrieri.



Drejtori Gazheli vlerësoi bashkëpunimin me Administratën Doganore Franceze, e cila daton para shumë vitesh dhe shtrihet pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë së Administratës Doganore, legjislative, ligji i akcizës, aposteriori dhe NCTS në kuadër të projekteve IPA, si dhe trajnimet e strukturave tona ligjzbatuese.



Drejtori i Doganave evidentoi faktin se ky trajnim është mjaft i rëndësishëm edhe për faktin se tregtia më e madhe e vendit tonë realizohet në rrugë detare, kryesisht ndërmjet Portit të Durrësit, Porto Romanos, Portit MBM, si dhe Portit të Vlorës.

Ai u shprehu homologëve gatishmërinë e Administratës Doganore Shqiptare për çarjen më tej të bashkëpunimit dhe asistencës së ndërsjellë në të gjitha fushat e veprimtarisë doganore e në veçanti për mbikëqyrjen dhe kontrollin doganor në transportin detar.

Takim me biznesin në Durrës



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me përfaqësues të biznesit në Durrës. Gjatë diskutimeve me anëtarët e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë ai u shpreh se Doganat mbeten të angazhuara në misionin e lehtësimit të procedurave doganore dhe mbrojtjes së tregtisë së ndershme.

Ai e vuri theksin te digjitalizimi i shërbimeve doganore, teksa dha lajmin se brenda vitit të gjitha procedurat doganore do të jenë online nëpërmjet e-Albania. Drejtori i Përgjithshëm, Genti Gazheli, i ftoi bizneset të aplikojnë për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar, (OEA) përmes të cilit mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore.



“Në këto vite kemi ndryshuar tërësisht qasjen ndaj biznesit me filozofinë që Doganat janë një institucion që i shërben biznesit dhe që ka mision kryesor për të siguruar procedura

doganore transparente dhe të parashikueshme, në funksion të realizimit të të ardhurave për buxhetin e shtetit, duke mbajtur ekuilibrin e duhur mes lehtësimit të procedurave dhe kontrolleve doganore,” u shpreh drejtori i Doganave, Genti Gazheli.

Takim me delegacionin e UNODC



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli mirëpriti një delegacion të UNODC, (United Nations Office on Drugs and Crime) drejtuar nga Danilo Rizzi, përfaqësues Rajonal për Europën Juglindore.

Forcimi i bashkëpunimit mes UNODC-së dhe Administratës Doganore Shqiptare, si dhe fushat e reja të bashkëpunimit në kuadër të Programit të ri Rajonal të UNODC-së për Europën Juglindore 2024-2029, ishin temat kryesore që u diskutuan gjatë këtij takimi.

Programi Rajonal për Evropën Juglindore synon të ndërlihdë dhe të sinergjizojë përpjekjet programore të UNODC në Europën Juglindore gjatë një periudhe 5-vjeçare nga 2024 deri në 2029 dhe mbështet aspiratat e rajonit për integrimin europian.

Tetor 2024

Forumi me bizneset në Shkodër

Forumi Biznes-Dogana vijoi në Shkodër, ku së bashku me bizneset që operojnë në këtë qytet u diskutua mbi lehtësimin e mëtejshëm të procedurave dhe vijimin e informatizimit të shërbimeve doganore. Takimi u vlerësua si mjaft i frytshëm teksa u evidentua se marrëdhëniet mes biznesit dhe doganave janë sot në ditët më të mira.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, tha se ka ndryshuar tërësisht qasja ndaj biznesit, ndërsa misioni kryesor është të sigurojë procedura doganore transparente në funksion të realizimit të të ardhurave për buxhetin e shtetit. Zhvillimi i sistemeve teknologjike është një proces i vazhdueshëm drejt përmirësimit, tha drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

“Të dhënat nga sistemi tregojnë se kemi ulje sinjifikative të kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut ndërkohë që janë përmirësuar ndjeshëm vlerësimet me transaksion që për periudhën Janar-Gusht 2023 ishin 97%, shifra më e lartë e përdorimit të transaksionit,” u shpreh Gazheli.

Bizneset nga ana e tyre vlerësuan përmirësimin e procedurave doganore dhe shtimin e aplikacioneve të reja që iu mundësojnë akses në kohë reale, duke parë në mënyrë transparente çdo fazë të miratimit të aplikimeve, lehtësimeve, përjashtimeve nga taksat etj..

Projekti Adriacustoms në Durrës



Drejtues dhe ekspertë të doganave italiane, sllovene, kroate dhe malazeze u mbledhën në Durrës në kuadër të Projektit Adriacustoms, që synon bashkëpunimin mes administratave doganore të vendeve që lagen nga deti Adriatik.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, gjatë fjalës së mbajtur në takim in e zhvilluar në Portin e Durrësit u shpreh se shkëmbimi i eksperiencave më të mira mes administratave doganore është çelësi për suksesin e përbashkët në luftën kundër kontrabandës, mallrave të falsifikuara dhe trafiqeve të paligjshme.

Ai vlerësoi veçanërisht bashkëpunimin me Administratën e Doganave dhe Monopoleve në Itali dhe Guardia di Finanza-n, me të cilat Dogana Shqiptare ka nënshkruar këtë vit një marrëveshje trilaterale.

Projekti Adriacustoms, i financuar dhe mbështetur nga OLAF dhe Agjencia Italiane e Doganave dhe Monopoleve, përfshin shkëmbim eksperiencash mes administratave doganore në Portin e Durrësit në Shqipëri, Portin e Barit, Ankonës dhe Triestes në Itali dhe Portin e Bar në Mal të Zi.

Forumi Dogana - Biznes në Tiranë

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, së bashku me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, organizuan Forumin Dogana - Biznes me fokus lehtësimin e procedurave doganore dhe informatizimin e mëtejshëm të shërbimeve doganore. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim me bizneset e kryeqytetit, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, deklaroi se nga 1 Janari 2025 hyjnë në fuqi rregullat e rishikuara të origjinës që do të lehtësojnë tregtinë nëpërmjet certifikatës elektronike të origjinës, duke ulur ndjeshëm kohën, por dhe kostot për bizneset.



Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Nikolin Jaka, tha ndër të tjera se, marrëdhëniet e Administratës Doganore me biznesin aktualisht janë mjaft pozitive. “Administrata Doganore po i shërben gjithnjë e më shumë biznesit, duke ofruar procedura doganore transparente dhe të parashikueshme, ku përveç realizimit të të ardhurave synon për të mbajtur një balancë mes lehtësimit të procedurave dhe kontrolleve doganore,” nënvizoi Jaka.



Forumi Biznes-Dogana u vlerësua si një mundësi e mirë për të diskutuar mbi përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe raportet me shërbimet doganore drejt standardeve të BE-së. “Besoj ndajmë të njëjtin mendim se ka një përmirësim të dukshëm të

vlërësimeve të biznesit ndaj Doganave, si një institucion që i shërben biznesit dhe që ka mision kryesor për të siguruar procedura doganore transparente dhe të parashikueshme,” u shpreh drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli.

Nga ana e bizneseve u vlerësua pozitivisht digjitalizimi i mëtejshëm i procedurave doganore dhe lehtësimi i eksportuesve drejt tregjeve rajonale dhe atyre të BE-së. Doganat ftuan përsëri bizneset të aplikojnë për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA) dhe Eksportues të Autorizuar për të përfituar nga lehtësitë procedurale, si dhe nga shumë thjeshtime doganore.

Bruksel, Takimi i 15-të i Nënkomitetit për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet



Shqipëria dhe Bashkimi Europian zhvilluan në datat 23 dhe 24 tetor 2024 në Bruksel Takimin e 15-të të Nënkomitetit “Për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet”. Përfaqësues nga Komisioni Europian diskutuan zhvillimet më të fundit në këto fusha me autoritetet përkatëse shqiptare. Takimi u bashkëkryesua për BE-në nga Z. Andrew Williams, Sekretar i Përhershëm për Nënkomitetin në DG NEAR të Komisionit Europian, ndërsa për Shqipërinë nga Z. Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare.

Gjatë këtij takimi dyditor, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, u shpreh se Shqipëria ka një kuadër ligjor të përputhur në shkallën më të lartë me legjislacionin

europian dhe mbetet thellësisht e angazhuar për përafrimin e plotë me “Acquis Communautaire” në fushën e doganave. Përfaqësuesit e Komisionit Europian vlerësuan pozitivisht progresin veçanërisht të Administratës Doganore Shqiptare sa i përket nivelit të përgatitjes ligjore, institucionale e administrative dhe planet e Shqipërisë për t’u bashkuar me Konventën e Përbashkët të Tranzitit.

Ekspertët e DG Taxud, Z. Antonio Blanco dhe Z. Karel de Greve, përgëzuan gjithashtu progresin që Dogana Shqiptare ka bërë në fushën e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, duke rritur numrin në 16 AEO.



Në takim u vlerësua gjithashtu fakti se, gjatë këtij viti, që përkoi me çeljen e negociatave për grupkapitujt themelore të integritit të Shqipërisë në BE, Doganat kanë përparuar në lehtësimin e tregtisë, implementimin e Strategjisë së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare (2023-2027), si dhe dispozita të tjera, si ato për kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara, apo ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore.

Përfaqësuesi i OLAF, Z. Paul Aleksander shprehu falenderime për përditësimin e pikës së kontaktit për MAA nga Dogana Shqiptare. Ai vlerësoi me nota të larta funksionimin me sukses të mekanizmit në fushën e asistencës së ndërsjellë administrative midis vendeve anëtare të BE-së dhe Shqipërisë, ndërsa theksoi se ky bashkëpunim i suksesshëm ishte përcjellë edhe nga vendet anëtare të BE-së. Ai vlerësoi gjithashtu operacionet e kryera nga Dogana Shqiptare gjatë dy viteve të fundit, si edhe luftën në kontrabandën e cigareve.

“Aleanca e Grave në Uniformë 2024”

Dogana Shqiptare ishte pjesë e Konferencës “Aleanca e Grave në Uniformë 2024”, nismë e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Shqipëri që u zhvillua për të dytin vit radhazi në Tiranë. Konferenca këtë vit trajtoi tema që lidhen me barazinë gjinore në strukturat e zbatimit të ligjit dhe mbështetjen e kësaj çështjeje në vendet e Ballkanit Perëndimor.



Znj. Aida Dizdari, kryetare e Degës Doganore Shkodër, e cila mbajti një fjalim në këtë event, theksoi se, fuqizimi i grave dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje janë hapa të domosdoshëm për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. “Aleanca e grave në uniformë” është nismë e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Shqipëri në bashkëpunim me Doganën Shqiptare, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Drejtësisë.

■ Nëntor 2024

Vizitë në Doganën e Kosovës

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Shqipërisë, Z. Genti Gazheli, zhvilloi një vizitë zyrtare në Doganën e Kosovës, ku u prit nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Z. Agron Llugali. Vizita u përqendrua në forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy institucioneve, si dhe përpjekjet e përbashkëta për lehtësimin e tregtisë mes dy vendeve. Gjatë takimit, të dy delegacionet diskutuan mbi operacionet e zhdoganimit në Portin e Durrësit, ku përpjekjet për të përmirësuar procedurat dhe shërbimet kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe kursimin e kohës për bizneset dhe qytetarët.



Po ashtu, u diskutua mbi bashkëpunimin në pikën e përbashkët kufitare Morinë - Vermicë, një hapësirë kyçe për shkëmbimet mes dy vendeve, ku teknologjitë dhe praktikët e fundit po zbatohen për të garantuar kalim të sigurt dhe efikas. Një pikë tjetër e rëndësishme e diskutimeve ishte procesi i integritit europian, duke pasur parasysh fillimin e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në BE. Ekipi shqiptar ndau informacione të vlefshme me Doganën e Kosovës, të cilat priten të ndihmojnë në përgatitjet e mëtejshme drejt përbushjes së standardeve europiane. Në përfundim të takimit, Drejtorët e Përgjithshëm ranë dakord për të forcuar bashkëpunimin në të gjitha nivelet për të përmirësuar kapacitetet dhe për të adresuar sfidat e përbashkëta në fushën e doganave. Ky partneritet i ngushtë synon të kontribuojë në lehtësimin e tregtisë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të të dy vendeve.

20 specialistë të rinj trajnim në Akademinë e Guardia di Finanza

20 specialistë të rinj të Administratës Doganore Shqiptare zhvilluan një trajnim mbi “Veprimtarinë e kontrollit dhe luftës së trafikut të paligjshëm në fushën doganore”, në Akademinë e Guardia di Finanza-s, në Ostia, Itali. Trajnimi është pjesë e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Administratës Doganore Shqiptare, Agjencisë Italiane të Doganave e Monopoleve dhe Guardia di Finanza-s, i cili u nënshkrua në muajin Prill të këtij viti në Tiranë.



Në ceremoninë e zhvilluar në nisje të këtij trajnimi ishin të pranishëm komandanti i Akademisë së Guardia di Finanza, gjeneral Francesco Mattana, shefi i Departamentit të Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza, Gjeneral Vito Giordano, si dhe Drejtori i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Agjencisë Italiane të Doganave e Monopoleve, Andrea Mazzella, i cili përcolli urimet më të mira për grupin e të rinjve të Doganës Shqiptare. Gjatë këtij trajnimi, përveç leksioneve dhe aktiviteteve praktike në terren mbi luftën ndaj trafikut të paligjshëm, kontrabandës dhe mashtrimit, u zhvillua edhe një vizitë studimore në aeroportin ndërkombëtar të Romës, "Fiumicino", ku të rinjtë u njohën me aktivitetet operacionale të kryera nga autoritetet në aeroport.

Takimi i Drejtorëve të Doganave të Ballkanit me vendet e BE, Budapest



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli mori pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë të Drejtorëve të Doganave të Ballkanit Perëndimor me vendet e BE-së, në Budapest, Hungari. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim ai u shpreh se procesi i integritit evropian dhe konvergjenca drejt Unionit Doganor po bëhen gjithmonë e më të prekshme për Shqipërinë falë edhe presidencës hungareze që i ka shtyrë gjërat shumë përpara.

“Jemi të ndërgjegjshëm se kemi hyrë në një proces intensiv të negociatave, jo vetëm për Kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”, por edhe të gjithë kapitujve të Tregut të Brendshëm dhe ky takim është një mundësi t’i thellojmë lidhjet midis Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, teksa vazhdojmë të ndërmarrim reforma konkrete ligjore për integrimin evropian si projekt madhor politik,” tha mes të tjerash drejtori i Doganave Shqiptare, Genti Gazheli.

Nga ana tjetër drejtori i Doganave theksoi se në funksion të tregtisë së lirë, nëpërmjet Marrëveshjes CEFTA është rritur bashkëpunimi mes Administratave Doganore të vendeve të rajonit, sidomos në fushat e shkëmbimit të informacionit, lehtësimit të tregtisë dhe luftës kundër trafikëve.

Në Samitin Botëror për Klimën, COP 29



Më 20 nëntor, në kuadër të Konferencës së 29 të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (COP29), u mbajt konferenca me temë “Doganat e Gjelbra: Dialogu mes Drejtuesve të Doganave”. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli, së bashku me drejtues të doganave nga vende të ndryshme të botës dhe përfaqësues të Organizatës Botërore të Doganave morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komiteti Shtetëror i Doganave të Republikës së Azerbajxhanit, ku për herë të parë u diskutuan çështjet doganore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë Konferencë u theksua roli strategjik i shërbimeve doganore në mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësia e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë drejtim. Ky aktivitet shënoi një hap të rëndësishëm si në zgjidhjen e problemeve globale mjedisore, ashtu edhe në rritjen e rolit të autoriteteve doganore në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Në takim u diskutuan gjithashtu masat e marra nga shërbimet doganore për të mbështetur nismën e Doganës së Gjelbër duke theksuar rolin e autoriteteve doganore në ekuilibrin ekologjik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Dhjetor 2024

Takimi i parë Rajonal i BE dhe UNODC



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, mori pjesë në takimin e parë Rajonal të Komitetit Drejtues të Programit të Promovimit të Veprimit të Përbashkët të BE dhe UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin).

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të efektshme të kontrollit kufitar në porte dhe aeroporte, ku autoritetet doganore kanë një rol të rëndësishëm krahas Policisë Kufitare, partnerëve ndërkombëtarë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli tha se Dogana Shqiptare ka pasur rezultate konkrete falë partneritetit me UNODC, si Programi i Kontrollit të Kontejnerëve, falë të cilit u identifikuan dhe ndaluan e mbi 1.5 ton kokainë. Po ashtu, përmes Njësisë së Kontrollit të Ngarkesave Ajrore, është përmirësuar ndjeshëm mbikëqyrja në aeroporte, duke rritur kapacitetet në luftën kundër trafikut të paligjshëm përmes rrugëve ajrore.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes SELEC dhe BKH

Në funksion të bashkërendimit të përpjekjeve për rritjen e bashkëpunimit më të ngushtë ndërkombëtar në zbatimin e ligjit, u nënshkrua në Rumani një Marrëveshje Bashkëpunimi mes SELEC dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në emër të BKH, marrëveshja u nënshkrua

nga Drejtoresha e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Znj. Aida Veizaj (Hajnaj) dhe në emër të SELEC, nga Drejtori i Përgjithshëm, Dr. Oğuz Serkant Akin.



Ceremonia u zhvillua në selinë e SELEC në Bukuresht në prani të një delegacioni të nivelit të lartë shqiptar, ku merrte pjesë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli. Z. Akin u shpreh se, “SELEC është besimplotë që ka një partner të ri dhe se ky bashkëpunim do të japë rezultate pozitive për të dyja palët”. Marrëveshja synon rritjen e bashkëpunimit mes BKH dhe SELEC në kryerjen e hetimeve cilësore në fushën e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Administrata Doganore ka shërbyer me devotshmëri dhe përkushtim edhe në orët e ndërrimit të viteve në çdo pikë doganore të Shqipërisë.



GËZUAR 2025!



V. PERFORMANCA E TË ARDHURAVE NGA DOGANAT

Të ardhurat e 12-mujorit 2024 janë realizuar në masën 229,6 miliardë lekë. Në krahasim me 12-mujorin 2023 është realizuar rreth +12,5 miliardë lekë më shumë (106%).

Një pasqyrë më e qartë e realitetit ekonomik të Administratës Doganore është grafiku i mëposhtëm:





Vlen për tu theksuar se, megjithë humbjen prej 17,2 miliardë lekësh nga kursi i këmbimit 12-mujori Janar-Dhjetor 2024 ngelet më i miri në historinë e Doganave Shqiptare.

Performanca e mallrave kryesore të akcizës:

Të gjithë artikujt e akcizës kanë një performancë shumë të mirë në të ardhura, krahasuar me 12-mujorin e vitit 2023. Si sasi në konsum, artikulli cigare është +66 ton, Karburanti +37,861 ton, Birra +5,809 ton dhe Kafja +190 ton, duke arritur kështu nivelet më të larta vitet e fundit.





Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare është realizuar numri më i lartë i deklaratave të përpunuara, ku rritjen më të madhe e ofrojnë deklaratat e importit 4, të cilat sjellin të ardhurat kryesore për administratën doganore, me 444,530 deklarata të përpunuara, shifra më e lartë e arritur vitet e fundit.

Por ajo që bie më shumë në sy është përmirësimi në shpejtësinë e përpunimit të deklaratave në kanalet e ndryshme doganore. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023-2024 kemi një ulje sinjifikative të kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut, që është edhe një ndër prioritetet e përmirësimeve procedurale të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Koha e përpunimit në kanalin e verdhë për periudhën Janar-Dhjetor 2023-2024 është ulur me 13 minuta, ndërkohë që kanali i kuq ka shënuar përmirësimin më të madh, **duke ulur kohën me 91 minuta.**

Reduktimi i kohës së përpunimit të deklaratave sjell lehtësim të tregtisë ndërkombëtare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e klimës së biznesit. Bizneset mund të importojnë dhe eksportojnë mallra më shpejt, duke ulur kostot e qëndrimit në dogana dhe duke përshpejtuar procesin e furnizimit të tregut. Nga ana tjetër, reduktimi i kohës rrit transparencën, duke minimizuar mundësitë për abuzime, ose vonesa të qëllimshme, gjë e cila do të rriste besimin midis bizneseve dhe administratës doganore.

VI. ZBATIMI I LIGJIT


VI.1. Lufta ndaj Kontrabandës

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, nga Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar), janë realizuar **3,414** kontrolle, nga të cilat **1,291** ose rreth **38%** kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, në bashkëpunim dhe me strukturat DPD, janë zbuluar **127** raste me shkelje doganore, ku **90** raste me penalitet, me një vlerë totale 30,121,200 Lekë.

Kontrollet e plota dhe efektiviteti Janar - Dhjetor 2023/2024:

Viti	Nr. kontrolleve në rregull	Nr. kontrolleve me penalitet	Total/kontrolleve të plota
2023	187	61	248
2024	1,201	90	1,291

Tabela krahasimore Janar - Dhjetor 2023/2024:



Sektori Tokësor ka kryer kontrolle në të gjithë territorin doganor dhe akset rrugore, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme.


Gjatë kontrolleve të ushtruara janë konstatuar: 90 raste me penalitet, me një total vlerë: **30,121,200 Lekë** për periudhën: **Janar - Dhjetor 2024**.

Tabela krahasuese e gjetjeve/shkeljeve dhe vlerës me të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar:

Drejtoria A/K	Raste të konstatuara me penalitet		Total/Vlera	
	Janar - Dhjetor 2023	Janar - Dhjetor 2024	Janar - Dhjetor 2023	Janar - Dhjetor 2024
Total:	61	90	18,454,842 Lekë	30,121,200 Lekë

Krahasuar me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2023 rezulton se, në vitin 2024, ka **29** raste konstatime/zbulime shkeljesh më shumë, ose **48%** më shumë, si dhe rritje të vlerës së penalteteve me **11,666,358 Lekë** më shumë, ose **(+63%** më shumë në vlerë).



Numri i rasteve dhe vlera totale, 2023/2024:



Numri i shkeljeve doganore (kontrabandë dhe kundërvajtje administrative 2023/2024):


Janar - Dhjetor 2023/2024				
Shkelja	Raste	Detyrimi i Shmangur	Penaliteti	Total
K/Administrative 2023	61	6,399,643	12,055,199	18,454,842 Lekë
K/Administrative 2024	90	8,455,791	21,665,409	30,121,200 Lekë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 vërehet se, kemi rritje të lartë të numrit të rasteve të K/Administrative dhe për rastet kontrabandë të konstatuara.

Numri i rasteve të K/Administrative & vlera e tyre, 2023/2024:

Numri i rasteve të kontrabandës dhe vlera e tyre 2023/2024:


Numri më i lartë i rasteve me shkelje, të konstatuara gjatë kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria e Antikontrabandës, në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera DPD, rezulton në zonat doganore: Durrës, Tiranë, Kakavijë, Qafë Botë/Sarandë, Morinë e më pas zonat e tjera doganore.

Numri i rasteve me shkelje dhe % e tyre, ndarë sipas zonave doganore 2024:



Gjatë vitit 2024, nga kontrollet e ushtruara nga njësitë e Antikontrabandës Tokësore, janë evidentuar dhe bllokuar **22** raste të mallrave të dyshuara për cënim marke, në sasinë: **30,844** copë veshje të ndryshme dhe aksesore, si dhe, **173.55 kg** artikuj të ndryshëm, të cilat janë përcjellë për verifikime të mëtejshme Drejtorisë së Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale.

VI.2. Lufta ndaj trafiqeve të paligjshme

Gjatë vitit 2024 grupet operative Antitrafik kanë ushtruar gjithsej 1284 kontrolle në të gjitha degët doganore në pikat kufitare në hyrje dhe në dalje të Republikës së Shqipërisë.

Nga këto kontrolle janë identifikuar 20 raste shkeljesh nga subjektet për artikuj si:

- substanca piroteknike,
- substanca injektuese botoks dhe hormone
- substanca narkotike
- sende me vlerë
- para të padeklaruara në kufi
- qenie të gjalla kontrabandë
- kontrabandë mallrash

Spektori Operativ ka marrë pjesë në operacione të përbashkëta me drejtori të tjera të Departamentit Operativ Hetimor dhe me Agjenci të tjera ligjzbatuese, si dhe ato homologe.



Sektori i Njësisë së Informacionit të Pasagjerit

Gjatë përpunimit të të dhënave ky sektor i ka dërguar për verifikim Sektorit Operativ emrat e shtetasve të targetuar nga sistemi ATSG. Gjatë periudhës Janar- Gusht janë dërguar për kontroll të evidentuar nga sistemi ATSG **759 shtetas nga të cilat kanë rezultuar 2 kapje dhe pjesa tjetër janë dërguar raste të aktivitetit të dyshimtë.**

Deklarimet Cash për vitin 2024

Për vitin 2024 totali i deklarimeve cash është 2384 deklarime, nga të cilat 1139 deklarime janë kryer nga bankat, 1205 deklarime nga individë/subjekte dhe 40 kapje/mosdeklarime.

Në hyrje rezultojnë 615 deklarime vullnetare nga individë/subjekte dhe 23 mosdeklarime. Në dalje rezultojnë 1205 deklarime nga bankat, 524 deklarime vullnetare nga individë/subjekte dhe 17 mosdeklarime.






Raportime të aktivitetit të dyshimtë

Gjatë vitit 2024, janë dërguar 7 RAD pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.


Kapjet Cash sipas hyrje-daljeve

Për vitin 2024 janë regjistruar 40 raste kapje/mosdeklarimi cash-i (23 raste në hyrje dhe 17 raste në dalje). Kapjet në hyrje dhe dalje të R.SH. kryesohen nga monedha EUR.




Kapjet Cash sipas P.K.K.

Numri më i lartë i mosdeklarimeve Cash sipas P.K.K. i përket degës doganore Kakavijë me 11 raste, ndjekur me D.D. Morinë me 9 raste, Rinas me 8 raste, Durrës me 6 raste, Kapshticë me 3 raste, Muriqan me 2 raste dhe Vlorë me 1 rast. Dega doganore Kakavijë gjithashtu kryeson dhe me numrin e valutës së sekuestruar (ALL; CHF; EUR; GBP; HUF; YOD)



Kapjet Cash sipas Monedhave

Monedha EUR, njësoj si në vitin 2023, edhe për këtë vit ka udhëhequr si në hyrje ashtu edhe në dalje, duke patur përqindjen më të lartë të mosdeklarimeve në krahasim me monedhat e tjera. Vandin e dytë e kryeson monedha GBP, ndjekur nga USD dhe NOK. Janë në total 9 monedha të përdorura në rastet e mosdeklarimeve (ALL,CHF,EUR,GBP,HUF,NOK,TRL,USD,YUD).



Arritjet Kryesore

- ✓ Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë e Inteligjencës Financiare janë kryer raportime të përmuajshme lidhur me deklarimet e Cashit, raportim mbi import-exportet e metaleve dhe gurëve të çmuar; raportim mbi nevojat për trajnime në kuadër të Objektivit II të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave për periudhën 2024 – 2030 dhe raportime për Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP).
- ✓ Kontribut në kuadër të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”, për Komponentin II – “Sektorët me risk të lartë të korrupsionit”.
- ✓ Kontribut në përgatitjet për vlerësimin nga komiteti Moneyval, në plotësimin e pyetësorëve të efektivitetit, duke mbështetur përgatitjet për vlerësimin nga MONEYVAL dhe siguruar përmbylljen e suksesshme të këtij procesi thelbësor për vitin 2026.
- ✓ Kontribut në procesin e Integritimit Europian në hartimin dhe zbatimin e masave dhe planeve të veprimit për të mbështetur procesin e Integritimit Evropian (Kap1, Kap24, Kap27, Kap29, Kap31).
- ✓ Kontribut në lidhje me identifikimin e risqeve për masat në Planin e Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024–2030.
- ✓ Rishikimi i “Manualit për mënyrën e procedurës së kontrollit të cash-it” në mbështetje të doganierëve për deklarimin e parave cash, çek, metale e gurë të çmuar në degë/pika doganore kufitare, duke bërë ndryshimet përkatëse në legjislacionin, në përmirësimin e procedurave të kontrollit dhe intervistimit.
- ✓ Rishikimi i draftit të parë të Pozicionit Negociues të Kapitullit 29 “Bashkimi Doganor”.

VI.3. Hetimi doganor

Drejtoria e Hetimit nisur nga informacione të strukturave të tjera të DPD-së, apo për çështje të nisura kryesisht pas mbledhjes së të dhënave si dhe kryerjes së veprimeve paraprake, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal në fushën e doganave për shmangje të detyrimeve doganore, apo detyrimeve të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 277 të ligjit Nr. 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Organit të Prokurorisë gjatë kësaj periudhe gjithsej **33** (tridhjetë e tre) kallëzime penale/referime.

Ndër veprat penale të referuara janë:

- “Kontrabanda me mallra të tjerë” të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal;
- “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë, ose me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës” të parashikuar nga neni 172 i K.Penal;
- “Kontrabanda me mallra që paguajnë akcizë, ose me pezullim të plotë, apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës ” kryer në bashkëpunim nga më shumë se tre persona dhe në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 172 dhe 25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- “Kontrabandë me mallra të liçensuara”, “Mosdeklarim në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga nenet 173-25, 179/a dhe 287 të Kodit Penal;
- “Tregtim dhe transportim të mallrave kontrabandë”, “Ruajtje dhe depozitim i mallrave kontrabandë” parashikuara nga neni 178, 179 dhe 25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- “Fshehje të të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal;
- Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë”, parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal;
- “Shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga 248 i Kodit Penal.
- “Kondrabanda me mallra të ndaluar ose të kufizuara”, parashikuar nga nenet 171 të Kodit Penal.
- “Shkelja e të Drejtave të Pronësisë Industriale”, parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal.

Për periudhën 01 Janar 2024 – 31 Dhjetor 2024:

- Janë dërguar në total **33** (tridhjetë e tre) referime në Prokurori
- Janë konstatuar **14** (katërmbëdhjetë) shkelje doganore kundërvajtje administrative
- Janë konstatuar **87** (tetëdhjetë e shtatë) shkelje doganore kontrabandë
- Janë dërguar Degëve Doganore **101** (njëqind e një) informacione për marrje vendimi

Detyrimi i shmangur	Penalitet	Total
33 140 727 lekë	120 573 081 lekë	153 713 808 lekë

Nr.	Raste me shkelje/referime total
1.	33 Referime të dërguara në Prokurori
2.	20 Procedime penale të deleguara nga prokuroritë
3.	14 Raste shkeljeje doganore kundërvajtje me detyrim doganor të shmangur 843 869 lekë dhe penalitet 2 644 235 lekë

4	87 Raste shkeljeje doganore kontrabandë me detyrim doganor të shmangur 32 296 858 lekë dhe penalitet 117 928 846 lekë
5.	101 Raste informacion për marrje vendimi dërguar Degëve Doganore për subjekte apo persona që kanë kryer shkelje administrative/penale

Përshkrimi i çështjeve më të rëndësishme:

- Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC), bazuar në procedurën e ndarjes së çmimeve për hetimet e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit brenda vendeve të SELEC, ka vlerësuar me çmimin e vendit të dytë Doganat Shqiptare, për bashkëpunimin Shqipëri-Turqi, në lidhje me hetimet ndërkombëtare të kryera për procedimin penal Nr 1030 e vitit 2023 për veprën penale “Trafikim i Narkotikëve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 , i Kodit Penal. Procedimi penal ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
- Është bërë arrestimi në flagrancë i 5 shtetasve të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera të DPD-së, për veprat penale të parashikuara nga nenet 173, 179-a, 287 dhe 25 të Kodit Penal. Janë sekuestruar 300 000 euro dhe 1.057.840 kokrra ilaçe (Pseudoephedrine) me peshë totale 417.1 kg të cilat janë lënë në ruajtje në Degën Doganore Rinas.
- Është dërguar referim dhe materialet e para hetimore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për veprën penale “Kontrabanda me mallra që paguajnë akcizë, ose me pezullim të plotë, apo të pjesshëm nga detyrimet doganore, ose të akcizës” kryer në bashkëpunim nga më shumë se tre persona dhe në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 172 dhe 25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në bashkëpunim me Autoritetet Doganore të Republikës së Kosovës është bërë bllokimi i 2 autobusëve të cilët rezultuan të mbushura kryesisht me ujë.
- Drejtoria e Hetimit ka qenë pjesë e Planit Operacional për Monitorimin e Hidrokarbureve për periudhën 01.08.-31.12.2024 në Porto Romano, me qëllim kontrollin dhe monitorimin e importit, mbajtjes dhe tregëtimit të produkteve energjitike të akcizës.
- Janë bllokuar 10560 kg çamçakëza të importuar nga Kina të markës “Orbit”. Kjo sasi u konfirmua se ishte e falsifikuar dhe mund të rezultonte e dëmshme për shëndetin.

Operacione të përbashkëta

- Është realizuar plani operacional “Armstrong XI” në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, me fokus luftën kundër trafikimit të armëve, pjesëve të tyre, municioneve dhe eksplozivëve (dhe jo vetëm), nëpërmjet pakove postare, i projektuar për të nxitur një integrim më të afërt në punë dhe rritjen e kapaciteteve të inteligjencës dhe hetimit.
- Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit është zhvilluar operacioni për goditjen e kontrabandimit dhe tregtimit të kundërligjshëm të produktit “Botulinum toxin”, i njohur si “Botox”. Janë proceduar penalisht administratorët e disa klinikave estetike, pasi dyshohej që produkti “Botulinum toxin” që u gjet në klinikat e tyre, ishte i kundraligjshëm dhe i kontrabanduar.
- Në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve është finalizuar operacioni “Cikago”. Janë arrestuar 2 shtetas dhe janë sekuestruar 5 kg lëndë narkotike cannabis sativa me vlerë tregu 90 000 euro.
- Në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve, pas një pune hetimore disa mujore, u godit një grup që trafikonte lëndë narkotike nga SHBA në Shqipëri me anë të shërbimit postar.
- Në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Seksionin e Krimit Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është vendosur sekuestro preventive ndaj pasurive në zotërim të shtetasve E. A., M. T., K. B., D. B., E. B., V. A., E. B. dhe pasurive të disa subjekteve tregtare të provuar si në administrimin e shtetasve të lartpërmendur, për veprën penale ‘Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale’, parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Nga vlerësimi paraprak rezulton se vlera e pasurive të jetë 50 milionë euro.

VI.4. Inteligjenca doganore dhe shkëmbimi i informacionit

Gjatë vitit 2024 është rritur bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me qëllim goditjen e shkeljeve doganore, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha doganat homologe, në veçanti me ato fqinje.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka vijuar koordinimi dhe bashkëpunimi i suksesshëm edhe me Qendrën për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore SELEC, në luftën e përbashkët kundër krimit ndërkufitar. Në Korrik të vitit 2024, Qendra për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore (SELEC) ka vlerësuar me çmimin e vendit të dytë Doganat Shqiptare në bashkëpunim me doganat turke për luftën kundër trafikëve. Sipas vendimit të Komitetit të SELEC dhe bazuar në procedurën e ndarjeve të çmimeve për Hetimet e Përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit brenda vendeve të SELEC, hetimi i përbashkët Shqipëri-Turqi ka fituar çmimin e dytë.

Në bashkëpunim me oficerin tonë ndërlidhës në SELEC janë organizuar dy takime operacionale ku kanë marrë pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Informacionit dhe Drejtorisë së Hetimit, përkatësisht, në datë 18 Janar 2024 në Stamboll/Turqi dhe në datë 7 Mars 2024 në Novi Sad/Serbi.

Dogana Shqiptare kryesoi takimin e 21^{të} të Task Forcës kundër Mashtrimit dhe Kontrabandës të SELEC që u organizua në datë 12 nëntor 2024 në Bukuresht, Ruman, në pwrpjekje të vazhdueshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal në fushën e tregtisë së paligjishme. Qëllimi i takimit ishte sigurimi i një forumi në të cilin pjesëmarrësit mund të diskutonin për qasjet rajonale në parandalimin dhe luftimin e mashtrimeve doganore dhe kontrabandës, duke synuar në përgjithësi forcimin e bashkëpunimit rajonal mes Doganës dhe Policisë në këtë fushë, si dhe vendosjen e drejtimeve të përbashkëta që duhen ndjekur në nivel rajonal.

Baza e të dhënave e rrjetit kombëtar të zbatimit doganor (**nCEN-national Customs Enforcement Network**) është funksionale që nga data 1 Mars 2021. Fillimisht nCEN u përdor në versionin 3.3.1. Gjatë vitit 2024 u krye upgrade dhe ka kaluar në **versionin 3.10.0**.

Arritjet e Administratës sonë Doganore janë pasqyruar edhe në **publikimin e fundit të revistës Herald**, botim i OBD-së. Në faqet 23-25 është pasqyruar Konferenca Rajonale mbi Lehtësimet Tregtare “Fuqizimi i Partneriteteve Bashkëpunuese në Epokën Digjitale” e cila u mbajt në datat 8-9 nëntor në Tiranë.

The screenshot shows a page from the WCO Herald magazine. The main article is titled "Regional Conference on Trade Facilitation reshapes Collaboration and Integration of the Western Balkans economies in the Digital Era". The article discusses the importance of trade facilitation and digitalization in the Western Balkans region, highlighting the role of the WCO and its member states in promoting economic growth and integration. The article is written by a WCO expert and includes several paragraphs of text. There are also images of people at a conference and a map of the region.

VI.5. Monitorimi dhe Analiza e Riskut

Specialistët e Monitorimit gjatë vitit 2024 kanë ndjekur dhe verifikuar 1361 deklarata doganore gjithsej të iniciuara nga monitorimi online i sistemit elektronik të përpunimit të deklaratave doganore. Të gjitha rastet janë ndjekur, koordinuar dhe raportuar në kohë reale.

Zbulimet e kontrolleve të ndjekura nga Specialistët e Monitorimit (2024)


Burimi i Informacionit	shkelje	detyrim	penalitet	total
SM	53	3,935,042	5,880,616	9,815,658
MONITORIME/VERIFIKIM PESHE	74	863,225	3,368,231	4,231,456
Total	127	4,798,267	9,248,847	14,047,114

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar rezultatet e kontrolleve me shkelje të ndara në detyrim, penalitet dhe totali i zbulimit sipas natyrës së shkeljes. Kemi një rritje të rasteve ku janë konstatuar keqklasifikim, kontrabandë, mallra të padeklaruara, parregullsi.

Lloji i shkeljeve	shkelje	detyrim	penalitet	total
MALLRA TE PADEKLARUAR	60	2,837,133	5,778,783	8,615,916
SHTIM DETYRIMI	4	510,532	1,205,941	1,716,473
KEQKLASIFIKIM	14	1,425,080	1,067,557	2,492,637
PARREGULLSI	48	-	1,120,000	1,120,000
MALLRA TE NDALUAR	1	25,522	76,566	102,088
Total	127	4,798,267	9,248,847	14,047,114

Në rast se do të analizojmë treguesit e performancës së punës me të dhënat e një viti më parë, kemi një rritje si të numrit të kontrolleve, ashtu edhe të totalit të penaliteteve dhe detyrimit të munguar si më poshtë:

	Ne rregull	Shkelje	Totali kontrolle	Detyrim i munguar	Penalitet	Total
KONTROLLE 2023	454	80	534	4,786,213	6,658,882	11,445,095
KONTROLLE 2024	1234	127	1361	4,798,267	9,248,847	14,047,114
DIFERENCA 2024/2023	63%	37%	61%	0%	28%	19%



Lehtësim i tregtisë së ligjshme

Në kuadër të lehtësimit të tregtisë së ligjshme, duke ruajtur edhe kontrollin bazuar në risk të qarkullimit të mallrave, mjeteve të transportit, apo personave specialistët e analizës së riskut gjatë vitit 2024 kanë punuar për rritjen e nivelit të kanalit Jeshil (pa kontroll) dhe uljen e nivelit të Kanalit të kuq (kontroll fizik). Kjo është arritur nëpërmjet rritjes së numrit të kompanive të listës “Green” e cila për vitin 2024 ka shkuar në 2,200 kompani, si dhe një targetimi më të mirë të kontrolleve fizike. Si rezultat, niveli i kanalit Jeshil në vitin 2024 është rreth 30.73%. Gjithashtu kemi dhe një ulje të nivelit të kontrollit fizik, i cili në vitin 2024 rezulton 6.57%.

Rishikimi i profileve të riskut

Aktualisht, në sistemin tonë doganor veprojnë 393 profile risku aktive¹ në import-eksport dhe 80 në tranzit.

Bazuar në fushat e riskut, struktura e profileve rezulton të jetë kryesisht profile me qëllim kontrollin për siguri, keqklasifikim, vlerë dhe akcizë të mallrave, përkatësisht 39%, 27%, 6% dhe 5%.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, puna e specialistëve të riskut ka konsistuar në zhvillimin e analizave të detajuara në funksion të identifikimit të fushave të riskut, fiskale dhe jofiskale, si dhe analizimit/vlerësimit të fenomeneve (keqklasifikime tarifore, siguri, akcizë ekonomike me risk, apo mbi operatorë të lartë, etj.), që pengojnë ADSH-në në realizimin e detyrave/misioneve të saj.

Profilat e riskut që i përkasin vitit 2024, ruajnë të njëjtën strukturë si ajo ekzistuese, pra pjesa më e madhe e tyre ka natyrë fiskale, konkretisht rreth 49% e totalit të profileve. Ndërsa pjesa tjetër me rreth 39% e totalit të profileve, përbëhet nga profilet e sigurisë.

Mbikëqyrja e vlerësimit doganor

Për vitin 2024, nga Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Doganor u janë dërguar degëve doganore për rishikim të vlerësimit doganor 2.240 raste. Nga rastet e kthyerat përgjigje, në 1,611 prej tyre ose 90% është ndërhyrë në vlerësim, rritur kjo me 10% krahasuar me vitin 2023. Vlera e detyrimeve shtesë për deklaratat e mësipërme për të cilat kemi përgjigje nga degët doganore për vitin 2024 ka qenë rreth 60 milion lekë, duke bërë që vlera mesatare për deklaratat e detyrimit shtesë si pasojë e ndërhyrjeve rezulton rreth 37,400 lekë.

Duhet theksuar se kjo është vlera më e lartë që ka raportuar ky sektor ndër vite dhe është një tregues i rritjes së efektivitetit të punës së sektorit dhe bashkëpunimit me degët doganore dhe strukturat e tjera të DPD, si p.sh., Drejtorinë e Auditit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Kontrolleve Pas Zhdoganimit.


¹ Të dhënat i referohen të dhënave në sistem në datë 31.12.2024.

VI.6. Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale

Gjatë vitit 2024, Administrata Doganore, ka pezulluar për çlirim në qarkullim të lirë **40,911** copë veshje të ndryshme dhe aksesorë, të cilat dyshohej se shkelnin një pronësi intelektuale të markave tregtare të ndryshme si: “Louis Vuitton”, “Moncler”, “Lacoste”, “Tommy Hilfiger”, “Channel”, “Adidas”, “Prada”, “Emporio Armani”, “Calvin Klein”, “Miu Miu”, “Nokia” etj, për të cilat ka një aplikim për veprim të miratuar pranë Autoritetit Doganor.

Gjithashtu, vlen të përmendim se gjatë vitit 2024, ADSH ka pezulluar 10650 kg çamcakëza të impotuar nga Kina, të markës tregtare “Orbit”, të cilat u konfirmuan nga mbajtësi i së drejtës se ishin të falsifikuar dhe mund të rezultonin shumë të dëmshëm për shëndetin e konsumatorit shqiptar.

Të dhënat statistikore krahasuese të mallrave të pezulluara të dyshuara si cënueset e një pronësie intelektuale për vitin 2023 vs 2024



VI.7. Kontrolli Aposterior

Gjatë vitit 2024, ka vijuar puna në përmbushje të detyrave funksionale me prioritet realizimin e të ardhurave doganore dhe luftën ndaj evazionit fiskal. Janë realizuar 50 Programe Kontrolli a-posteriori mbi:

- Regjimin e Përpunimit Akti:
- Vlerësimi doganor i mallrave:

Rezultatet e kontrolleve 2024 krahasuar me vitin 2023

Strukturat e ngarkuara		Kriteret e matjes së performancës	Viti	
			2023	2024
Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit	Sektori i Aposteriorit	Numri i kontrolleve fizike / dokumentare të kryera	25	50
		Numri i kontrolleve të rezultuara me shkelje	12	20
		Detyrime doganore (lekë)	67,463,444	1,866,837
		Penalite (lekë)	136,420,462	4,433,623
		Norma e suksesit në lidhje me numrin e kontrolleve të realizuara	48%	400%
		Numri i rasteve të kallëzuara penalisht	1	0

Në zbatim të Ligjit nr.102/2014, dt. 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë konstatuar detyrime doganore të munguara në shumën **1,866,837 lekë**, penalitetet **4,433,623 lekë**, në total **6,300,460 lekë**.

VII. DEPARTAMENTI TEKNIK

VII.1. Procedurat Doganore

Informimi dhe sensibilizimi i subjekteve është në fokus të sektorit me qëllim ndërgjegjësimin e tyre rreth përfitimeve që sjell statusi AEO dhe rritjen e numrit të aplikimeve e certifikatave të lëshuara. Gjithashtu, informimi dhe trajnimi i degëve doganore lidhur me përfitimet e këtij statusi, si dhe trajtimi prioritar i këtyre bizneseve me besueshmëri të lartë është në fokus të sektorit, duke zhvilluar trajnimet përkatëse.

- Trajnimet me degët doganore në bashkëpunim me QTAD
- Trajnim me përfaqësues të institucioneve që veprojnë në kufi si (AKU) në bashkëpunim me GIZ

Programi i Operatorit Ekonomik të Autorizuar sipas modelit përkatës të BE-së është zbatuar që nga viti 2019 me përmbylljen e plotë të bazës ligjore të nevojshme dhe hartimin e programit kombëtar të AEO-ve.

Aktualisht, janë miratuar 16 Operatorë Ekonomikë të Autorizuar nga 27 aplikime të paraqitura për këtë qëllim.

Duke patur parasysh rëndësinë që ka njohja reciproke e AEO-ve në rajon dhe më gjerë, fillimisht, janë hartuar dhe nënshkruar marrëveshjet për njohjen reciproke për AEO me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, si dhe janë hartuar protokollat përkatëse në kuadër të nismës Open Balkan në muajin nëntor 2022.

Objektivi i rëndësishëm në këtë kuadër mbetet hartimi i marrëveshjes për njohjen reciproke me BE-në, duke patur në konsideratë Programin Kombëtar të Zhvillimit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, i cili i është prezantuar grupit të ekspertëve të vendeve të CEFTA-s dhe ky i fundit ka dhënë një opinion pozitiv për Shqipërinë në vitin 2022, duke rekomanduar validimin e këtij programi e duke hapur kështu rrugë marrëveshjeve për njohjen reciproke të AEO-ve me vendet e CEFTA-s.

Bazuar në Udhëzimin nr. 06, datë 19.10.2020 "Për zbatimin praktik të procedurave të aplikimit, miratimit, funksionimit dhe mbikëqyrjes së objekteve doganore dhe Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar" tashmë po operohet me ndërtimin e programeve të monitorimit të veprimtarisë së AEO-ve.

Aktualisht, është duke u testuar moduli përkatës në sistemin informatik të doganës "Asycuda World" për Aplikimet dhe Autorizimet/Certifikata AEO, në bashkëpunim me UNCTAD. Lidhur me testimin e modulit përkatës është realizuar takimi me përfaqësuesin e UNCTAD për këtë qëllim dhe priten nga ana jonë zhvillimet e mëtejshme për procedimin e testeve.

Gjithashtu, në bashkëpunim me vendet anëtare të CEFTA-s, është krijuar AEO database lidhur me shkëmbimin e të dhënave për AEO në rajon.

Zhvillimi i Sistemit të Ri të Kompiuterizuar të Tranzitit – platformës NCTS,

Aktualisht statusi i Aktivitetit WBTF-ALB-121B-1 që është i lidhur me zhvillimin dhe implementimin e Sistemit Common Transit (Tranzitit të Përbashkët me BE) NCTS është si më poshtë:

Në muajin Prill 2024, pas shqyrtimit të kompanive ofertuese nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), për përzgjedhjen e kompanisë fituese, janë përmbyllur procedurat dhe dërguar raportet e vlerësimit të Bankës Botërore.

Pas shqyrtimit, periudhës së ankimit, Banka Botërore ka nënshkruar kontratën me kompaninë fituese Net Company/Intrasoft në muajin Qershor 2024, me tenderimin e vetëm të produktit Soft, pasi pajisjet dhe network i produkteve Hardware do të ofrohet nga institucioni i AKSHI-t, propozim ky i ardhur nga AKSHI dhe i miratuar tashmë nga Banka Botërore.

Për sa më sipër, në bashkëpunim me kompaninë që do të implementojë sistemin NCTS, me konsulencën e një eksperti ndërkombëtar dhe PIU (Njësia Zbatuese e Projektit) Administrata Doganore ka draftuar dokumentin me specifikimet teknike nacionale të cilin e ka dërguar në DGTAXUD, ka hartuar urdhrin për ngritjen e grupit të punës që do të marrë pjesë në këtë proces gjatë gjithë fazës së implementimit, si dhe ka përgatitur dokumentin NCTS P5 of NPP “National Project Plan and IT Strategy”.

Projekti i Sportelit të Vetëm Doganor (Single Window);

Statusi i Aktivitetit, Zbatimi i sistemit të Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Window – NSW)”, me Nr. Ref. WBTF-ALB-112CDEF, është si më poshtë:

Më 14 tetor deri më 10 dhjetor 2024, CFCU në Ministrinë e Financave ka publikuar procedurën e tenderit për Aktivitetin WBTF-ALB-112CDEF “Zgjidhja në dorë e projektit të zbatimit të kontratës NSW”.

Është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), për përzgjedhjen e kompanisë fituese për aktivitetin “Zbatimi i sistemit të Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Window – NSW)”, me Nr. Ref. WBTF-ALB-112CDEF.

Konsulenti IOS& Epes që është përgjegjës për Aktivitetin WBTF-ALB-111AB – 112AB – “Dizajnimi i projektit, specifikimet teknike, mbikëqyrja dhe sigurimi i cilësisë së zbatimit të dritares së vetme kombëtare (NSW) në Shqipëri (Kontrata PSQA)” ka dorëzuar detyrën 4 “Ndrysho Strategjia e Menaxhimit dhe Plani i Ngritjes së Kapaciteteve për Mbikëqyrjen e projektit për Mbështetjen e Menaxhimit dhe sigurimin e cilësisë së zbatimit të NSW në Shqipëri”, kur miratohet nga Përfituesi dhe Banka Botërore.

Nga Sektori i Procedurave dhe Regjimeve Doganore

Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2024 janë realizuar për regjime të posaçme përmes platformës e-Albania 1658 aplikime.

Kemi pasur 9 shërbime online përmes platformës e-Albania të cilave u janë shtuar dhe 4 shërbime të tjera gjatë vitit 2024, aktualisht në total kemi 13 shërbime online.

Janë përditësuar në sistem 12.864 autorizime për regjime të posaçme.

Nga analiza e bërë ka rezultuar se koha e procesimit të autorizimeve për aplikimet e ndryshme që realizohen përmes portalit e-Albania është zvogluar dhe konkretisht;

- Për vitin 2023 koha mesatare ka qenë 3.94 ditë

- Për vitin 2024 koha mesatare ka qenë 3.81 ditë

Nga Sektori i Lehtësirave Doganore

Aktualisht kemi 1 shërbim online përmes platformës e-Albania të cilit do t'i shtohet dhe një shërbim tjetër, gjithsej do të shkojë në 2 shërbime online.

Për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024 janë realizuar:

Janë përditësuar në sistem 4934 kompetencat sipas kërkesave të Degëve Doganore.

Janë përditësuar në sistem 3023 NIPT-e të reja të ardhura nga Sektori i Borxhit.

Janë kthyer 449 përgjigje nëpërmjet email-it nga Sektori i Lehtësirave Doganore.

Janë shqyrtuar dhe kthyer përgjigje për 32 raste plotësim dokumentacioni për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale.

Janë shqyrtuar dhe miratuar 163 urdhra për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale.

Janë shqyrtuar dhe miratuar 7 Autorizime për përdorimin e procedurës së Deklarimit të Thjeshtëzuar.

Janë autorizuar 5 subjekte për Operatorë Ekonomikë të Autorizuar, AEO.

Digjitalizimi/Inovacioni i shërbimeve doganore

- Është ulur koha mesatare e shqyrtimit të aplikimeve online nëpërmjet e-Albania:

Për vitin 2023 ishte 3.94 ditë

Për vitin 2024 u bë 3.81 ditë

VII.2. TARIFA

Objektivat e sektorit:

1. Përmirësimi dhe plotësimi i akteve normative.
2. Hartimi i VKM për "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025", përditësimi në sistem i NKM 2025.
3. Shqyrtime kërkesash në afat dhe dhënie autorizimesh të ndryshme.
4. Ndjekja e Projektit: Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave (ITMS)

Realizimi i çdo objektivi pasqyrohet si më poshtë:

I. Përmirësimi dhe plotësimi i akteve normative

1. Është përgatitur dhe është në proces miratimi në bashkëpunim me Laboratorin Doganor Udhëzimi (i rishikuar) mbi “Proçedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të çertifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor”.
2. U realizua dërgimi i VKM për “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025”, si dhe përditësimi në sistem i NKM 2025.
3. U realizua në afat përditësimi në systemin AW i NK 2025, si dhe rregullat e taksimit.

II. Shqyrtime kërkesash dhe dhënie autorizimesh të ndryshme

Për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024 janë realizuar përmes platformës e-Albania

- **493** Aplikime

Aplikim për makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë, ose më të madhe se 500 milionë (pesëqind milionë) lekë, të cilat nuk janë për shitje	75
Aplikim për makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit	147
Aplikim për Trajtim Tarifor Favorizues: mallra industriale	14
Autorizim Informacion i Detyrueshëm Tarifor	5
Autorizim përjashtimi nga detyrimet doganore	252

Janë menaxhuar në sistemin elektronik doganor AW përditësimet për subjekte të rindërtimit për 92 subjekte.

Janë realizuar trajnime mbi klasifikimet tarifore dhe procedurat e përjashtimeve nga TVSH.

Sa i përket administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të “çertifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor janë kryer:

- 6702 Çertifikata të klasifikimit tarifor, nga të cilat 197 kanë rezultuar me ndryshim kodi tarifor të deklaruar;
- 65 Fletë -Analiza të hartuara;
- Hartuar dhe mbyllur afërsisht 60 shkresa;

- Në proces (sistemi LIMS) janë afërsisht 6807 praktika, për të cilat duhet të ndiqet procedura e analizimit dhe e klasifikimit për praktikat e ardhura për klasifikimin tarifor të mallit.

III. Projekti ITMS:

1. Kompania zhvilluese SIVECO dhe partneri IKUB-INFO kanë kryer prezantimet e moduleve të sistemit ITMS.
2. Grupi i specialistëve të DPD me përfaqësues nga sektori i tarifës, sektori i origjinës, sektori i procedurave, analiza e riskut dhe sektori TIK, janë trajnuar dhe kanë kryer testimet në sistem.
3. 8 modulet e kërkuara të sistemit janë zhvilluar nga kompania SIVECO, janë instaluar në infrastrukturën harduerike në AKSHI dhe janë kryer testet e tyre. Soft-i i moduleve është dorëzuar në shkurt 2024.
4. Ndërlidhja me sistemet e BE do të jetë efektiv 1 vit përpara anëtarësimit.

VII.3. ORIGJINA

Gjatë vitit 2024 është punuar në drejtim të hartimit, adoptimit dhe zbatimit të ndryshimeve të Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave në kuadër të standardizimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025.

Sistemi i Menaxhimit i Tarifës së Integruar (ITMS), në kuadër të Planit Kombëtar për Koordinimin e Politikës Trgetare dhe Lehtësimin e Tregtisë.

Projekti për Implementimin e ITMS ka përfunduar fazën e parë të tij:

Grupi i specialistëve të DPD me përfaqësues nga sektori i tarifës, sektori i origjinës, sektori i procedurave, analiza e riskut dhe sektori TIK, janë trajnuar dhe kanë kryer testimet në sistem. Janë zhvilluar 8 modulet e kërkuara të sistemit, janë instaluar në infrastrukturën harduerike në AKSHI dhe janë kryer testet e tyre. Në fazën vijuese do të realizohet ndërlidhja me sistemet e BE e cila do të jetë efektive 1 vit përpara anëtarësimit.

Përmirësimi dhe plotësimi i akteve normative

1. Është përgatitur dhe është në proces miratimi në bashkëpunim me Laboratorin Doganor Udhëzimi (i rishikuar) mbi "Procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të çertifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor".
2. U realizua dërgimi i VKM për "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025", si dhe përditësimi në sistem i NKM 2025.
3. U realizua në afat përditësimi në sistemin AW i NK 2025, si dhe rregullat e taksimit.

VII.4. LABORATORI DOGANOR

Arritjet për vitin 2024, Laboratori Doganor ka kryer analizimin në kohë reale dhe me profesionalizëm i 6882 mostra ose 61990 tregues analitikë, nga të cilat 6168 mallra akcize (rreth 90 %).

Laboratori ka marrë statusin “Laborator i akredituar” nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për 84 tregues analitikë, më datë 30 Prill 2024. Certifikata e akreditimit është e vlefshme për periudhën 30 Prill 2024- 29 Prill 2028.

Laboratori doganor ka marrë pjesë në 8 Teste të Zotësisë: 5 të organizuar nga GCSL (General Chemical State Laboratory) Greqi dhe 3 nga Agjensia e Doganave Italiane. Është punuar për përditësimin e formularëve dhe procedurave të ndjekura në laborator me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara në planin e vizitës vlerësuese të Ekspertëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.



VIII. AKCIZA

Përgjatë vitit 2024 Drejtoria e Akcizës ka kryer mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin, sipas produkteve specifike të magazinave fiskale të prodhimit dhe stokimit, ka kontrolluar dhe monitoruar lëvizjen e produkteve të akcizës nën pezullim, si dhe zbatimin e kushteve e respektimin nga operatorët e akcizës të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve, si dhe ka bashkëpunuar me strukturat e tjera qëndrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për kontrollin dhe monitorimin e produkteve energjitike pas mbylljes së procesit të markimit.

Bazuar në planin vjetor të miratuar, strukturat e kësaj drejtorie kanë kryer analizime të ndryshme lidhur me importimin, prodhimin, stokimin dhe lëvizjen e produkteve të akcizës, sipas llojit të tyre. Janë ushtruar kontrole për të saktësuar, apo përditësuar normativat teknike në procesin e prodhimit dhe koeficientet e humbjeve dhe të firove.

VIII.1. Kontrolli i Akcizës

Të ardhurat nga produktet e akcizës janë zëri kryesor në totalin e të ardhurave doganore. Konkretisht të ardhurat neto nga produktet e akcizës zënë 44% të totalit të të ardhurave doganore të realizuara përgjatë 2024 (**101,769,243 nga 229,519,901**).

Produktet me ndikimin më të madh në të ardhurat nga akciza janë:

- Karburantet, 22.5% e totalit të të ardhurave doganore
- Cigaret dhe nënproduktet e duhanit, 15% e totalit të të ardhurave doganore
- Produktet e tjera të akcizës zënë rreth 16.5% të totalit të të ardhurave doganore

Më konkretisht, po ju paraqesim një pasqyrë me ecurinë e produkteve të akcizës përgjatë vitit 2024:

- Karburantet kanë patur një nivel realizimi prej **58,977 ton, ose 9.4%** më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Cigaret dhe Produktet e duhanit** kanë patur një nivel realizimi prej **205 ton ose 6.4%** më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Kafja** ka patur një nivel realizimi prej **68 ton, ose 1%** në sasi më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Pijet alkoolike** kanë patur një nivel realizimi prej **599,000 litra, ose 5.8%** më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Birra** ka patur një nivel realizimi prej **5,092,000 litra, ose 5.6%** më shumë krahasuar me vitin 2023.

A. SEKTORI I PIJEVE ALKOLIKE

Në bazë të detyrave funksionale, ky sektor ka kryer kontrole si në tregje, ashtu dhe pranë operatorëve ekonomikë që operojnë me produkte akcize. Nisur nga prioritetet dhe risku, ky sektor është përqendruar në kontrollin e operatorëve me kontribut më të madh në të ardhura, kryesisht importuesit dhe prodhuesit e produkteve të akcizës “birrë”, “pije alkoolike” dhe “verë”. Mbi bazën e analizës së riskut janë evidentuar operatorët ekonomikë me risk të shtuar, si dhe janë ushtruar kontrole pranë këtyre operatorëve ekonomikë.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë kryer **90 kontrole** nga të cilat 42 janë importues të produkteve verë, birrë dhe pije alkoolike, ndërsa 48 janë prodhues vendas të produkteve verë, raki, pije alkoolike dhe birrë. Nga kontrollat e ushtruara janë evidentuar detyrime dhe penalitete në **7 raste me detyrime të munguara në vlerën prej 1,202,919 lekë dhe penalitete në masën prej 3,717,773 lekësh.**

B. SEKTORI I DUHANIT DHE PRODUKTEVE TE TJERA

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024, janë hartuar gjithsej 57 programe kontrolli. Të gjithë programet e kontrollit janë hartuar duke u bazuar në indikatorët e riskut të parashikuar në Udhëzimin Nr. 2 Prot. dt. 28.01.2023 “Për Manualin mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës” të ndryshuar. Nga kontrollat e ushtruara, me shkelje ka rezultuar 1 (një) operator ekonomik, për të cilin janë ndjekur procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Siç duken nga rezultatet e kontrollit, duke qenë se është shtuar numri i kontrolleve dhe prezenca Doganore, operatorët janë sensibilizuar lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore dhe zbatimit të legjislacionit me korrektësi.

C. SEKTORI I PRODUKTEVE ENERGETIKE

Gjatë vitit 2024 Sektori i Produkteve Energjetike pranë Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës ka qenë i angazhuar në përbushjen e detyrave funksionale dhe arritjes së objektivave të parashikuara në Planin e Punës për vitin 2023. Veprimtaria e këtij Sektori ka qenë e mbështetur në legjislacionin përkatës.

Gjatë periudhës Janar – Korrik 2024 kemi bashkërenduar punën dhe veprimtarinë ditore me koncesionarin GFI. Ky bashkëpunim ka konsistuar në gjurmimin, verifikimin dhe kontrollin e shenjimit të produkteve energjetike të hedhura në qarkullim në territor.

Janë kryer 2.176 kontrole ose rreth 272 kontrole në muaj;

- Janë kryer 3.200 teste/analiza ose rreth 400 teste/analiza në muaj;

- Janë gjetur fail (të pamarkuar) 13 raste, 6 prej tyre vetëm në muajin maj;

Në lidhje me rastet fail (të pamarkuara) janë kryer të gjitha procedurat e verifikimit dhe ndëshkimit sipas legjislacionit në fuqi.

Krahas kontrolleve të mesipërme janë ushtruar dhe 4 kontrole në operatorë fiskalë, nga të cilët njëri prej tyre rezultoi me shkelje, për të cilin janë marrë masa në zbatim të përcaktimeve ligjore.

Në periudhën pas përfundimit të kontratës konçesionare të markimit, punonjësit e sektorit të produkteve energjitike janë angazhuar në kontrolle/verifikime në grupe të përbashkëta me punonjës të Departamentit Operativ Hetimor në DPD. Ky bashkëpunim ka vazhduar deri në datë 31.12.2024 bazuar në Planin Operacional të miratuar nga titullari i institucionit, plan i cili kishte qëllim kontrollin dhe mbikëqyrjen e produkteve energjitike. Ky bashkëpunim ka rezultuar efikas në parandalimin e shkeljeve dhe ndërgjegjësimin e operatorëve referuar rezultateve të sasive të produkteve energjitike të hedhura për konsum në territor gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 (58,977 ton më shumë).

D. SEKTORI I PAJISJEVE MATËSE DHE LINJAVE TEKNOLOGJIKE

Përgjatë vitit 2024, Sektori i pajisjeve matëse dhe linjave teknologjike ka ushtruar programe kontrolli me tematika të ndryshme, si më poshtë:

1. Në lidhje me objektivin “Për parandalimin dhe zbulimin e shkeljeve në fushën e akcizës me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga akciza”, Sektori i Pajisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike ka kryer 36 kontrolle pranë operatorëve kryesisht prodhues të pijeve alkoolike, verë dhe raki me qëllim verifikimin e rrezes së prodhimit, si dhe përditësimin e normativave të prodhimit dhe koeficientët e humbjeve/frove.

Këto kontrolle janë ushtruar bazuar në një analizë risku, duke marrë si indicie, sasitë e ngarkuara të lëndës së parë rrush në sistem për vitin 2024 nga operatorë të ndryshëm, deklaratimet në kontabilitetin e stokut në sistemin EMCS, si dhe frekuencën e kontrolleve të ushtruara.

2. Në lidhje me objektivin “Parandalimi dhe shmangia e evazionit fiskal”, nga SPMLT janë zhvilluar 25 kontrolle me tematikë “Verifikim Teknik i Magazinave Fiskale, Verifikim i kartës teknologjike. Këto kontrolle të Magazinave Fiskale kanë përfshirë 5 operatorë përpunues të produkteve Energjetike, 10 operatorë prodhues Birre, 3 operatorë përpunues të Nargjilesë dhe 7 operatorë prodhues të verës, rakisë dhe pijeve alkoolike.

Në total janë kryer 61 kontrolle dhe janë realizuar përgjithsisht në periudhat e planifikuara sipas planit vjetor të punës.

VIII.2. DREJTORIA TEKNIKE E AKCIZËS

Në zbatim të detyrave funksionale dhe objektivave të vitit 2024, nga ana e këtij Sektori:

- Janë proçeduar **101 autorizime** për **përfitim** e nivelit të diferencuar të akcizës
- Janë lëshuar **34 autorizime të përjashtimit** nga akciza të **trupit diplomatik** në bazë të kuotave të miratuara nga Ministria e Jashtme
- **Krijimi i kodit shtesë për 950 përjashtime nga akciza të karburantit të anijeve të peshkimit**

Bazuar në pikën 3 shkronja “d” të nenit 10 të Ligjit 61 / 2012 “Për Akcizat”; nenit 20 të VKM

nr. 612 / 2012 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat" i ndryshuar; Udhëzimit nr. 18, dt. 15.06.15 "Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gasoil) me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza",

- **Janë regjistruar 650 garanci** në sistemin informatik doganor të dërguara nga degët doganore për depozituesit e miratuar, si dhe garancitë për pullat fiskale.
- Aplikime në sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes së pullave **SICPATRACE**

Porosi pulla fiskale – 2454 porosi të miratuara

SKU- 252 aplikime

Shtesë furnitori- 261 aplikime

Krijim profili- 133 aplikime

- Mbajtja e korrespondencës shkresore me struktura të brendshme të sistemit doganor dhe jashtë tij.
- Është bashkëpunuar me degët doganore dhe institucione të tjera për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme juridike e teknike në fushën e akcizave.
- Janë reflektuar në sistem ndryshimet e nivelit të akcizës për produktet e duhanit, sipas kalendarit 2025.

a. Sektori i Autorizimeve

Sektori i Autorizimeve ka zhvilluar veprimtarinë e tij, në zbatim të detyrave funksionale dhe objektivave të vitit 2024.

Sektori Autorizimeve, ka të projektuar gjithsej 5 shërbime online nga të cilat 3 shërbime janë funksionale online ndërsa 2 shërbime janë për tu implementuar. Me implementimin e këtyre shërbimeve, Sektori i Autorizimeve kalon tërësisht online.

Koha mesatare e shyrimit (Miratimit) të shërbimeve online, është 3-5 ditë.

Në zbatim të detyrave funksionale dhe objektivave të vitit 2024, më poshtë disa të dhëna statistikore:

Statistika:

- Aplikime online për autorizime të reja, të miratuara gjithsej: 27 aplikime
- Modifikime autorizimi, shtesa, apo ndryshime në autorizimin fillestar të magazinës fiskale/pritësit të regjistruar, të miratuara gjithsej: 27 raste
- Pushim vlefshmërie (revokime) autorizim për magazinë fiskale dhe pritës të regjistruar gjithsej: 59 operatorë
- Përditësim i afatit të autorizimit për magazinat fiskale në sistem: 252 raste
- Përditësim i afatit të autorizimit për pritës të regjistruar në sistem: 161 raste

Është bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të ngushtë me degët doganore, duke komunikuar në kohë reale në back-end apo e-mail, për plotësimin në një kohë sa më të shkurtër të dokumentacionit të munguar dhe me qëllim procedimin sa më të shpejtë të aplikimeve të operatorëve për autorizim për magazinë fiskale dhe pritës të regjistruar.

IX. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Në funksion të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, apo marrëdhënieve ndërkombëtare janë organizuar vizita të delegacioneve doganore të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe të delegacioneve të Doganës Shqiptare jashtë vendit. Në këtë kuadër është koordinuar puna mbi zhvillimin e takimeve të nivelit të lartë, bilaterale dhe multilaterale me administratat doganore të vendeve fqinje.



Organizata Botërore e Doganave (OBD)

Shqipëria është anëtare e OBD-së që prej gushtit 1992 dhe që prej asaj kohe merr pjesë aktivisht në takimet e Këshillit të OBD-së, komiteteve dhe nënkomiteteve, duke përfituar nga eksperiencat më të mira të vendeve të zhvilluara dhe duke i implementuar ato në sistemin tonë doganor. Gjatë viteve të fundit, Dogana Shqiptare ka marrë pjesë intensivisht në programet e ndryshme trajnuese të OBD-së, të cilat synojnë të investojnë tek nëpunësit civil me potencial të lartë të Administratës Doganore Shqiptare, duke zgjeruar mundësitë, aftësitë dhe njohuritë e tyre, në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në procesin reformues dhe modernizues të administratës së tyre.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar këto aktivitete:

- Dogana Shqiptare ka marrë pjesë intensivisht në programet e ndryshme trajnuese të OBD-së të cilat synojnë të investojnë tek menaxherët e mesëm me potencial të lartë dhe të zgjerojnë mundësitë, aftësitë dhe njohuritë e tyre, në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në procesin reformues dhe modernizues të administratës së tyre.
- Takimet e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor dhe takimet e komiteteve/nënkomiteteve të ndryshme (si: Komiteti i Përhershëm Teknik, Komiteti i Sistemit të Harmonizuar, Komiteti Teknik i Origjinës, Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve, Komiteti i Menaxhimit të Konventës së Rishikuar të Kiotos, Komiteti i Zbatimit të Ligjit, Komiteti Teknik për Vlerësimin e Doganave, Nënkomiteti i Integritetit, Sesionet 143/144-të të Këshillit të Organizatës Botërore të Doganave, etj.);
- Konferenca të ndryshme (si: Konferenca Globale e PGS, Konferenca mbi përditësimin e Udhëzuesit të Informacionit Paraprak të Pasagjerëve, Konferenca Globale mbi Origjinën, Konferenca e Drejtuesve të Doganave të Rajonit të Europës”, etj.);
- Operacione të ndryshme (si: PANDORA VI, DEMETER VII, STOP II);
- Webinare dhe grupe pune (si: Grupi i Punës SAFE, etj.).
- Është plotësuar dhe përcjellë pranë OBD-së:
 - Raporti vjetor “Annual Survey 2024”,
 - WCO Survey, Smart Customs Project (ku është emëruar edhe Pika Kombëtare e

Kontaktit për këtë projekt).

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave është dhënë kontributi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në plotësimin e Raporteve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).
- Është siguruar pjesëmarrja e personelit doganor në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me OBD-në, GIZ-in, Ambasadën Britanike (HRMC), CEFTA, UNODC etj..
- Është siguruar pjesëmarrja në Sesionin e Këshillit të SELEC të zhvilluar më 30 Maj 2024, Bukuresht.
- Sesioni i 23-të i Nënkomitetit të Integritetit të OBD-së. (Bruksel, Belgjikë)
- Takimi i 31-të i Grupit të Punës të Pan Euro Mesdhe të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale, (Bruksel, Belgjikë)
- Sesioni 42-të i Komitetit Teknik të Rregullave të Origjinës. (Bruksel, Belgjikë)
- Workshop mbi Zonat e Lira Ekonomike për Rajonin e Europës. (Shkup, Maqedoni e Veriut)
- Sesioni 143/144 i Këshillit të OBD-së. (Bruksel, Belgjikë)
- Workshop Rajonal në kuadër të "Projektit Sirius". (Zagreb, Kroaci)
- Takimi i 26-të i PKK-së të RILLO-s. (Kisinau, Moldavi)
- Takimet mbi Operacionin "Horizont i sigurt". (Varshavë, Poloni)
- Trajnim në kuadër të projektit RANDA. (Larnaka, Qipro)
- Programi i profesionistëve të laboratorit OBD. (New Dehli, India)

Programi i Kontrollit të Eksportit dhe Çështjeve të Sigurisë së Kufirit (EXBS)

Programi EXBS (Export Control and Related Border Security) për Kontrollin e Eksporteve dhe Sigurinë Kufitare ka qenë dhe vijon të jetë një nga partnerët kryesorë të Shërbimit Doganor Shqiptar në mbështetjen e përpjekjeve tona për përmirësimin e kontrollit të kufirit dhe parandalimin e lëvizjes së mallrave me risk, në mënyrë të veçantë të mallrave të përdorimit të dyfishtë dhe atyre radioaktive. Gjithashtu EXBS ka kontribuar në rritjen e përfundimit të Shërbimit Doganor në aktivitetet ndërkombëtare, (konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete rajonale e ndërkombëtare trajnimi) me objekt kontrollin e mallrave të përdorimit të dyfishtë, përfshi në mënyrë të veçantë ato për kontrollin e lëndëve radioaktive, si dhe ka organizuar ndër vite trajnime për stafin doganor.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur aktivitetet si më poshtë:

- Trajnim për krimin e organizuar mjedisor dhe korrupsionin. (Opatija, Kroaci)
- Workshopi Rajonal i Ballkanit Perëndimor. (Zagreb, Kroaci)
- Menaxhimi i Kufijve në Ballkanin Perëndimor. (Tivat, Mal i Zi)

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

Falë partneritetit me UNODC kemi arritur të përmirësojmë ndjeshëm mbikëqyrjen në portet dhe aeroportet tona, duke rritur kapacitetet në luftën ndaj trafikut të paligjshëm. Dogana Shqiptare ka pasur rezultate konkrete falë partneritetit me UNODC, si Programi

i Kontrollit të Kontejnerëve falë të cilit u identifikuan dhe ndaluan e mbi 1.5 ton kokainë. Po ashtu, përmes Njesisë së Kontrollit të Ngarkesave Ajrore, është përmirësuar ndjeshëm mbikëqyrja në aeroporte, duke rritur kapacitetet në luftën ndaj trafikut të paligjshëm përmes rrugëve ajrore. Po kështu, gjatë vitit 2024 është zhvilluar kursi kundër financave të paligjshme në Mostar, Bosnia & Herzegovina, si dhe është mbajtur dhe një takim konsultativ teknik lidhur me ngritjen e një qendre rajonale për shkëmbimin e informacionit në fushën e menaxhimit dhe sigurisë së kufirit detar në Larnaka, Qipro.

CEFTA CEFTA

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA 2006) është një marrëveshje rajonale moderne dhe gjithëpërfshirëse e tregtisë së lirë, e hartuar si një pjesë integrale e axhendës së para-anëtarësimit. Ajo siguron një bazë të fortë ligjore për formulimin dhe zbatimin e politikave në fushat kyçe që lidhen me tregtinë dhe investimet. Zbatimi i suksesshëm i Marrëveshjes deri më sot me liberalizimin e plotë të tregtisë së mallrave ka kontribuar ndjeshëm në krijimin e një zone të tregtisë së lirë në Europën Juglindore. Shtetet Anëtare të CEFTA-s kanë rënë dakord për një agjendë ambicioze për të kontribuar më tej në rritjen ekonomike.

Gjatë vitit 2024 me mbështetjen e CEFTA-s janë realizuar disa aktivitete:

- Takimi rajonal mbi menaxhimin e riskut doganor. (Shkup, Maqedoni e Veriut)
- Takimi i 27 i Nënkomitetit për Rregullat e Origjinës. (Prishtinë, Kosovë)
- Vizitë studimore për përmirësimin e zbatimit të programeve të AEO në CEFTA. (Bruksel, Belgjikë)
- Takimi i Komitetit Drejtues i Korsive Jeshile. (Sarajevë, Bosnia & Herzegovina)
- Trajnimi Rajonal në Analizat e të Dhënave Doganore. (Shkup, Maqedoni e Veriut)
- Takimi i 28-të i Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e Origjinës. (Prishtinë, Kosovë)
- Takimi për sistemin SEED + dhe Strategjinë e Menaxhimit të Riskut. (Budva, Mali i Zi).

Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ Albania) Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Një mbështetje të madhe për realizimin e prioriteteve të CEFTA-s është mundësuar në kuadër të bashkëpunimit me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

GIZ ka mbështetur aktivitetet rajonale me fokus mbështetjen në integrimin ekonomik rajonal, implementimin e duhur të strategjisë rajonale të menaxhimit të riskut, ndërgjegjësimin e operatorëve për përfitimet e OEA, hartimin e drafteve ligjore për deklarimet e vlerave monetare në kufi, manualeve për hetimin doganor dhe antikntrabandën, apo dhe mbështetjen për trajnime mbi pajisjen me qen.

Me mbështetjen e Projektit të GIZ-it janë bërë të mundura për tu realizuar disa aktivitete për vitin 2024:

- Takimi i forcimit të bashkëpunimit të Autoriteteve Doganore dhe agjensive të

- mbikëqyrjes së tregut. (Petrovac, Mali i Zi).
- Programi global i flukseve të paligjshme financiare. (Shkup, Maqedoni e Veriut).
- Takim rajonal mbi programet e OEA-ve. (Budva, Mal i Zi)
- Vizitë studimore në Qendrën e DHL [Leipzig, Gjermani]

Është zhvilluar gjithashtu një seminar i përbashkët ndërmjet Administratës Doganore dhe agjencive sanitare dhe fitosanitare (SPS) nga Shqipëria dhe Kosova, organizuar në datat 21 dhe 22 Maj 2024 në Durrës, me objektivin për të mundësuar një shkëmbim “peer-to-peer” mbi praktikën më të mirë në lidhje me reformat e ndërmarrë nga të dy qeveritë për lehtësimin e tregtisë për kompanitë AEO, mbi sfidat praktike me të cilat përballen bizneset, si dhe për nevoja për bashkëpunim gjithëpërfshirës ndërmjet agjencive të zbatimit në kufi.

Gjetjet kryesore të GP-ve kombëtare (nga aktivitetet e sipërpërmendura), u prezantuan në një forum rajonal me qëllim krahasimin e sugjerimeve, vlerësimin e zgjidhjeve më të përshtatshme në nivel rajonal duke mundësuar zhvillimin e një qasjeje të përbashkët dhe të harmonizuar për inspektimet e përbashkëta të kompanive AEO në nivel rajonal.

Në periudhën raportuese, projekti organizoi tre workshope për ngritjen e kapaciteteve, një kombëtare (26 dhe 27 qershor 2023, Maqedoni e Veriut) dhe dy rajonale (28 - 30 qershor 2023 dhe 20 mars 2024) për analitikën e të dhënave doganore. Seminaret synonin mbështetjen e Palëve të CEFTA-s për të përsheptuar marrjen e analizave moderne të të dhënave dhe përfshirjen e burimeve të reja të të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të rrezikut doganor në nivel kombëtar dhe rajonal. Fokus i veçantë iu kushtua analitikës së të dhënave, qasjeve të bazuara në rrezik dhe kritereve të rafinuara të përzgjedhjes për të zgjeruar aftësinë e tyre për të mbledhur të dhëna të besueshme mbi flukset tregtare dhe për të analizuar këto të dhëna për shënjestrimin efektiv të ngarkesave të bazuara në rrezik.

Sekretariati i Përhershëm i Komitetit të Transportit



Komiteti i Transportit është një organizatë ndërkombëtare në fushën e lëvizshmërisë dhe transportit, ku Shqipëria është shtet anëtar i saj. Synimi kryesor i Komitetit të Transportit është që të asistojë në zbatimin dhe miratimin e legjislacionit të BE-së në fushën e transportit dhe duke mbështetur projektet që lidhin partnerët rajonalë të Ballkanit Perëndimor, mes tyre dhe në BE.

Gjatë vitit 2024 Komiteti i Transportit ka zhvilluar takime për të zhvilluar infrastrukturën e pikave doganore në Shqipëri dhe jo vetëm.

- Takimi i Komitetit Drejtues për Korsitë Jeshile. (Zagreb, Kroaci)
- Takimi i Komitetit Teknik për lehtësimin e transportit. (Sarajevë, Bosnia & Hercegovina)
- Komiteti Teknik për transportin e mallrave të rrezikshme. (Podgoricë, Mali i Zi)
- Takimi i Komitetit Teknik për lehtësimin e transportit. (Ohër, Maqedoni e Veriut)

Projekti Adriacustoms

Drejtuës dhe ekspertë të Doganës Shqiptare në datat 16 – 17 Prill 2024 morën pjesë në aktivitetin e prezantimit të Projektit Adriacustoms që synon bashkëpunimin mes administratave doganore të vendeve që lagen nga deti Adriatik në luftën kundër kontrabandës, mallrave të falsifikuara dhe trafikeve të paligjshme. Projekti i financuar dhe mbështur nga OLAF dhe Agjencia Italiane e Doganave dhe Monopoleve, përfshin shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis Doganës Shqiptare dhe Doganave Italiane, Sllovene, Kroate dhe Malazeze.

Gjatë vitit 2024 në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar:

- Sesioni i shkëmbimit të ekspertëve në kuadër të Projektit Adriacustoms (Bari, Brindisi, Itali)
- Zbatimi i strategjive të kontrolleve të përbashkëta doganore në Detin Adriatik (Durrës, Vlorë)
- Sesioni i shkëmbimit të ekspertëve në kuadër të Projektit Adriacustoms (Podgoricë, Mal i Zi)

HMRC

I iniciuar në vitin 2022, Ambasada Britanike në Tiranë filloi një projekt për të trajtuar pabarazitë dhe barrierat në punë me të cilat përballen gratë në uniformë, lidhur me zbatimin e ligjit. Projekti synon të trajtojë tre elementë thelbësorë: Ndryshimet institucionale (duke përfshirë qëndrimet dhe proceset), aftësitë (forca, fitnesi, luftimet dorë më dorë) dhe pajisjet (nga produktet higjienike deri tek uniformat). Kjo Shoqatë ka të bëjë me trajtimin e barazisë kur bëhet fjalë për ngarkesat financiare, trajtimin në punë, trajnimin dhe rekrutimin.

Pas shumë aktiviteteve, trajnimeve dhe takimeve të zhvilluara gjatë vitit 2022, 2023 (të cituar në dy botimet e mëparshme) edhe në vitin 2024 u realizua sërish Konferenca “Aleanca e Grave në Uniformë 2024”, e cila siguroi edhe këtë vit forumin ku gratë nga të gjitha organizatat të kenë mundësinë të punojnë në një hapësirë të sigurt ku mund të ndajnë përvojat e tyre edhe në arenën europiane.

Konferenca u dëgjua nga 41 pjesëmarës nga Administrata Doganore. Konferenca u mbështet nga Atasheu mbrojtës, Timothy Wight Boycott, oficer i ushtrisë britanike, znj. Keqmezi Rexhepi, anëtare e kryesisë në Sindikatën e Pavarur të Doganave të Kosovës (TUKC) dhe avokatët për mirëqenien e punëtorëve, si dhe folës të tjerë nga rajoni dhe Europa.

Projekti NCTS

Në vitin 2024 një hap i rëndësishëm është hedhur për implementimin e NCTS-P5, duke ngitur një grup pune për implementimin e saj si një kriter i vendosur nga Bashkimi Europian për Kapitullin 29. Është kontraktuar kompania Net Company Intrasoft nga

Ministria e Financave dhe Banka Botërore dhe projekti pritet që të zgjasë 19 muaj, ku parashikohen shumë trajnime dhe testime, duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe praktikat më të mira. NCTS është procedura doganore e tranzitit e cila lejon lëvizjen e mallrave nga një zyrë doganore në tjetrën në të njëjtin territor doganor, ose nga një territor doganor tjetër, pa mbledhur detyrimet dhe taksat që mund të zbatohen për mallrat e importuara, ose të eksportuara dhe pa zbatuar ndalime ekonomike, ose kufizime dhe me kusht që të plotësohen të gjitha kërkesat në lidhje me vulat doganore, afatet kohore, ose sigurinë.

Projekti “Rrjeti Pan-Evropian i Praktikantëve të Doganave” (PEN-CP)

PEN-CP është një projekt 5-vjeçar (Shtator 2018 - Janar 2024), i financuar nga programi i BE Horizon 2020, i rrjetit të praktikuesve të sigurisë, me 13 administrata doganore europiane (BE dhe jo BE) si partnerë aktivë, ndër ta edhe ADSH. Programi PEN-CP mund të përshkruhet si një rrjet i ri për nxitjen e inovacionit doganor dhe një platformë online, që ofron shërbime të vlefshme ndërmjetësuese të inovacionit. ADSH ka vijuar të marrë pjesë në aktivitetet dhe studimet në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2024.

Projekti Single Window

Nisma për Projektin Implementimi i Sistemit Kombëtar të Single Window nis pas ratifikimit me ligjin nr. 62/2019, të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perendimor. KGH Customs është kontraktuar nga Ministria e Financave dhe Banka Botërore, me qëllim identifikimin dhe përzgjedhjen e opsioneve, duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe praktikat më të mira për vendimet strategjike kyçe që do të merren për komponentët e çdo njësie të National Single Window.

IX.1. Integrimi European

Procesi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin European është konsideruar si prioritet strategjik kombëtar, i cili udhëheq agjendën qeverisëse të vendit. Në Qershor të vitit 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit, e cila hyri tërësisht në fuqi në Prill të vitit 2009. Që nga Qershori i vitit 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në Bashkimin European. Marrja e statusit të vendit kandidat shënon një hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, pasi reflekton ecurinë e reformave të ndërmarra dhe i hap rrugë procesit të plotë të aderimit të vendit tonë në Bashkimin European.

Aktualisht Shqipëria është në fazën e hapjes së bisedimeve për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin European dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si institucion është jo vetëm e përfshirë drejtpërdrejtë në dhënien e kontributit të saj në Kapitullin 29, “Bashkimi Doganor”, por është njëkohësisht institucion kontribuues edhe

në Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, Kapitullin 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”, Kapitullin 16 “Tatimet”, Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” dhe Kapitullin 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore”.

Në këtë kuadër janë përmbushur detyrimet e DPD në lidhje me:

- Procesin e analizimit, përditësimit dhe plotësimit të informacionit shqip dhe anglisht për Kapitullin 29, 33, 24, 7, 16, 30, si dhe mbi realizimin e detyrimeve të Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2024 – 2026.
- Plotësimin/përditësimin e rekomandimeve të KE-së 2024, për Kapitullin 29 “Dogana”.
- Kontributin e DPD-së lidhur me monitorimin javor të PKIE 2024;
- Kontributin për Raportin e Progresit për Kapitullin 29 “Dogana”;
- Kontributin për Raportin e Progresit për Kapitullin 33 “Dispozitat Buxhetore dhe Financiare”;
- Kontributin për Raportin e Progresit për Kapitullin 24 “Drejtësia, Siguria dhe Liria”;
- Nënkomitetin BE-Shqipëri “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”
- Nënkomitetin BE-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- Progamin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Europian (PKABE) 2024-2030 dhe Planin Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2024 – 2026. Po punohet për finalizimin e Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2025 – 2027.
- Platformën e Partneritetit për Integrimin Europian për Kapitullin 29;
- Monitorimin për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian për vitin 2024 për Kapitullin 29 “Dogana”.
- Pjesëmarrjen në takimet online lidhur me përgatitjen e pozicionit negociues për Kapitullin 29 “Dogana”;
- Sigurimin e pjesëmarrjes në Nënkomitetin Shqipëri-BE “Drejtësia, Siguria dhe Liria”, zhvilluar më 20-21 Mars 2024, në Bruksel.
- Takimi i 15-të i Nënkomitetit për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet.
- Përgatitja e draftit të parë të Pozicionit Negociues për Kapitullin 29 “Dogana”.
- Plotësimi i CAF për Kapitullin 29 “Dogana”, Kapitullin 16 “Tatimet”, Kapitullin 24 “Drejtësia, Siguria dhe Liria”.
- Pjesëmarrje në takime periodike online me Ministrinë e Financave për Kapitullin 29 “Dogana”, Kapitullin 33 “Dispozitat Buxhetore dhe Financiare”, Kapitullin 24 “Drejtësia, Siguria dhe Liria”.

IX.2. Bashkëpunimi me partnerët

Administrata Doganore Shqiptare, si pjesë e rrjetit ndërkombëtar doganor dhe të agjencive ligjzbatuese, përgjatë vitit 2024 është përfshirë intensivisht për rritjen e rolit dhe pranisë së saj ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të strukturave të saj në aktivitetet që synojnë mbrojtjen e interesave ekonomike dhe të sigurisë kombëtare dhe rritjen e kapaciteteve teknike e administrative dhe që konsistojnë kryesisht në:

- pjesëmarrjen dhe menaxhimin e aktiviteteve e projekteve të bashkëpunimit administrativ dhe asistencës teknike të financuara nga Bashkimi Europian dhe nga organizma të tjera ndërkombëtare; (Binjakëzim BE, ITMS, Comobilion, Horizon 2020 + BB – SE, NCTS, Qafë Thanë, Hunter – Border Force, EXBS)
- pjesëmarrjen në nisma ndërkombëtare (përfshirë ato rajonale) dhe programe bashkëpunimi me struktura të ngjashme europiane dhe ndërkombëtare (OBD, DG. Taxud, SELEC, OLAF, CEFTA, Open Balkan);
- përfaqësimin ndërkombëtar të insitucionit (takimet bi/multilaterale, TR, GR, KS, Balkan 6, CEFTA WEEK);

Më konkretisht:

Në vizionin drejt një dogane me standardet e doganave të vendeve anëtare të BE-së, është hartuar Strategjia e Biznesit për Administratën Doganore Shqiptare 2023-2027", me asistencen e projektit TALEX të BE-së. Në kuadër të saj u hartua dhe miratua Plani 2-vjeçar i Zbatimit të Strategjisë së Administratës Doganore Shqiptare 2024-2025.

Me qëllim rritjen e transparencës me publikun dhe reflektimin e saktë dhe të qartë të veprimtarisë dhe arritjeve të punës së ADSH, për vitin 2024, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare (dogana.gov.al) të institucionit janë publikuar rregullisht aktivitetet e ndryshme të saj, kapjet dhe zbulimet në kuadër të luftës kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme (trafikimin e substancave narkotike, vlerave monetare, klandestinëve, mallrave të akcizës, etj.), si dhe njoftimet për operatorët ekonomikë dhe individët mbi risitë dhe lehtësitë në procedurat doganore, përmirësimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, punësimin në administratën doganore, etj..

X. RITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE

Administrata Doganore Shqiptare është në përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur me sukses misionet e saj, si atë fiskal, të lehtësimit të tregtisë, mbrojtës, si dhe të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në proçeset e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Me qëllim përshtatjen në interes të përmbushjes së veprimtarisë administrative, realizimit të misionit institucional dhe në funksion të rritjes së efciencës në punë, për t'iu përgjigjur sfidave të reja, me VKM-në nr.355, datë 26.05.2022 "Për disa ndryshime në vendimin nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, Për personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar, është miratuar struktura e re organizative e Administratës Doganore Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përbëhet nga 1.074 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përbëhet nga 429 punonjës dhe është e organizuar si më poshtë:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- Departamenti Administrativ;
- Departamenti Teknik;
- Departamenti Operativ-Hetimor;
- Departamenti i Akcizës;
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Për shkak të dinamizmit të administratës doganore, si dhe përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e performancës dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe subjekteve përgjatë vitit 2024, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DPD në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike kanë zhvilluar 86 procedura rekrutimi në shërbimin civil. Në përfundim të procedurave të rekrutimit, 21 nëpunës janë bërë pjesë e Administratës Doganore nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, 4 nëpunës nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe 61 punonjës u bënë pjesë e Administratës Doganore nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Administrata Doganore ka në përbërje 965 punonjës, nga të cilët 685 kanë statusin e nëpunësit civil. 31.1% e Administratës Doganore janë gra dhe vajza.

X.1. Trajnimet dhe Etika profesionale

Spektori i Trajnimeve gjatë vitit 2024 ka organizuar dhe menaxhuar trajnimin e personelit doganor në dy drejtime:

1. Trajnime të iniciuara nga projekte specifike, të rekomanduara nga KLSH, apo institucione të ndryshme
2. Trajnime sipas Programit Vjetor me QTATD

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në total janë zhvilluar 37 tematika të ndryshme trajnimesh me pjesëmarrjen e 340 punonjësve.

Në zbatim të programit vjetor të miratuar me QTATD (Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore) për rritjen e aftësisë profesionale dhe në përputhje me nevojat e punonjësve, është zbatuar Programi i Trajnimeve sipas Kalendarit të aprovuar me QTATD. Sipas Kalendarit vjetor të miratuar është realizuar 100% Programi Vjetor 2024.

Janë realizuar 42 tematika trajnimi sipas target-grupeve:

Për target grupin “Niveli Funkcional i Administratës Doganore” janë zhvilluar 17 tematika ku janë trajnuar 321 punonjës.

Për target grupin “ Niveli Vazhdues i Administratës Doganore” janë zhvilluar 8 tematika ku janë trajnuar 327 punonjës.

Per target grupin “Punonjësit e rinj” (48 punonjës) janë zhvilluar 17 tematika të nivelit bazë dhe janë trajnuar 685 punonjës.

Në total, Sektori i Trajnimeve ka menaxhuar 79 tematika dhe janë trajnuar 1673 punonjës.

X.2. Përmirësimi i Infrastrukturës doganore

Investimet e realizuara në vitin 2024

I. Në kuadër të bashkëpunimit ndër-rajonar për lehtësimin e tregtisë dhe transportit, në bashkëpunim me Bankën Botërore, është zhvilluar projekti “Punimet fizike në PKK Qafë Thana sipas projektimit” me Nr. WBTF-ALB-131C, pjesë e “Projektit të Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor - Shqipëri”, ku kanë filluar punimet në PKK Qafë Thanë të cilat priten të përfundojnë brenda vitit 2025.



II. Gjatë vitit 2024, në kuadër të forcimit të kontrollit dhe luftës kundër trafikëve të paligjshme, në pikat kufitare është zhvilluar procedura për blerjen e pajisjeve të kontrollit të bagazheve të pasagjerëve (skaner) për Degët Doganore:

- D.D. Sarandë, copë 1
- D.D. Kapshticë, copë 1
- D.D. Kakavijë, copë 1
- D.D. Rinas, copë 1

Instalimi i këtyre pajisjeve do të rrisë cilësinë e kontrolleve të bagazheve të pasagjerëve dhe do shkurtojë kohën e kontrollit, duke ruajtur balancën e duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme. Gjithashtu në vitin 2025 për të njëjtin qëllim do të zhvillohet e njëjta procedurë për Degët Doganore:

- D.D. Qafë Thanë, copë 1
- D.D. Morinë, copë 1
- D.D. Sarandë, copë 1

III. Në kuadër të rehabilitimit të portave hyrëse dhe dalëse në Republikën e Shqipërisë janë kryer investime në infrastrukturën e Degës Doganore Bllatë, duke zhvilluar procedurën “Blerje kabina kontrolli për Degën Doganore Bllatë”.



IV. Në kuadër të rehabilitimit të portave hyrëse dhe dalëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe të një Dogane më miqësore, janë kryer riparime mirëmbajtjeje të hapësirave dhe piktura të muraleve të Degëve Doganore si më poshtë:

Dogana Kapshticë



Dogana Qafë Thanë



Pika Doganore Muriqan



Pika Doganore Hani i Hotit



Dogana Morinë



XI. PRIORITETET PËR VITIN 2025

- Realizimi i fazës së tretë të mbulimit me kamera për degët doganore Porto Romano, Qafë Botë, Blladë, Sarandë, Muriqan dhe Aeroporti i Kukësit. Ky është një nga prioritetet më të rëndësishme i cili pritet të finalizohet brenda tre muajve të parë të këtij viti në bashkëpunim me AKSHI-n dhe Ambasadën Britanike, si financuese e këtij projekti.
- Zhvillimi i Moduleve të Avancuara të Riskut: Integrimi i moduleve të reja teknologjike për analizën e riskut do të mundësojë identifikimin më të saktë të ngarkesave me risk të lartë, duke përdorur algoritme të avancuara dhe inteligjencë artificiale.
- Reduktimi i Kontrolleve Fizike dhe Dokumentare: Duke zbatuar moton “kontrollo më pak të kontrollosh më mirë”, synohet ulja e numrit të kontrolleve fizike, duke u fokusuar vetëm në rastet me risk të lartë. Kjo do të përmirësojë efikasitetin dhe do të reduktojë kohën e pritjes për operatorët ekonomikë.
- Trajnimi i Personelit: Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit doganor për përdorimin efektiv të moduleve të reja të riskut dhe për zbatimin e metodologjive moderne të menaxhimit të riskut.
- Përmirësimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional: Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin në menaxhimin e riskut.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës: Krijimi i mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e efektivitetit të moduleve të reja të riskut, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve.
- Ndjekja e ecurisë në vazhdim lidhur me: Zhvillimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit – platformës NCTS, Projektin e Sportelit të Vetëm Doganor (Single Window); Implementimin e modulit për Aplikimet dhe Autorizimet/Certifikata AEO në sistemin “Asycuda World”; Korridorin e Gjelbër me vendet CEFTA; Komitetin e Lehtësimit të Tregtisë; Projektin “Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal” ORF/FT-GIZ, për pjesën e AEO-ve; Implementimin e Modulit të postave të shpejta për mundësinë e përdorimit të të dhënave të avancuara elektronike (EAD- Electronic Advanced Data); Ndërveprimin e sistemit “Asycuda World” me AKU Net; Implementimin e deklarimit parambërritjes/para daljes për Postën Shqiptare në sistemin “Asycuda World”; Plotësimin e sistemit BackEnd të aplikimeve me 5 shërbime të tjera online.
- Zbatimi korrekt i dispozitave kalimtare mbi rregullat e origjinës për vitin 2025: Vazhdim i trajnimeve në lidhje me zbatimin korrekt të dispozitave kalimtare të origjinës preferenciale që pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2025.
- Analizimi në kohë reale dhe me profesionalizëm i mostrave të ardhura në Laborator: Përmirësimi i vazhdueshëm Sistemit të Cilësisë në përputhje me kërkesat e Standardit SSH ISO/IEC 17025:2017; Zgjerimi i gamës së treguesve analitikë të akredituar me tregues të rinj; Rritja e pjesëmarrjes në Testet e Zotësisë, si një mjet i rëndësishëm për rritjen e kompetencës dhe besueshmërisë së Laboratorit Doganor.

- Përmirësimi dhe plotësimi i akteve normative: Hartimi i VKM për “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2026”, përditësimi në sistem i NKM 2026. Ndjekja e Projektit: Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave (ITMS). Klasifikimi tarifor për të gjitha mallrat e ardhura nga Degët Doganore përkatëse, apo struktura të tjera, pas analizimit të tyre nga Drejtoria e Laboratorit Doganor.

XII. Kontaktet:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Adresa postare:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5, Tiranë.

Numra kontakti:

Help Desk Tel: +355 42 232 988 (orari 08:00- 24:00/ 7 ditë)

e-mail: helpdesk.dpd@dogana.gov.al

Info Point Tel: +355 42 253 820 (orari 8.00 - 16.00 nga e hëna në të premte)

Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale

e-mail: antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al

Zv.Drejtor i Përgjithshëm Administrativ

e-mail: zvdrejtoraadministrativ@dogana.gov.al

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

e-mail: burimenjerezore.dpd@dogana.gov.al

Zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik

e-mail: zvdrejtorteknik@dogana.gov.al

Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Akcizës e-mail: zvdrejtoraakcize@dogana.gov.al

Drejtoria e Origjinës dhe Tarifës e-mail:

sorigjina.dpd@dogana.gov.al , starifa.dpd@dogana.gov.al

Drejtoria e Procedurave dhe Garancive

e-mail: sprocedurat.dpd@dogana.gov.al

Drejtoria Juridike

e-mail: juridiku@dogana.gov.al

Zv.Drejtor i Përgjithshëm Operativ Hetimor

e-mail: zvdrejtordoh@dogana.gov.al

Drejtoria e Informacionit

e-mail: drejtoriainformacionit.dpd@dogana.gov.al

Drejtoria e Analizës së Riskut

e-mail: risku@dogana.gov.al , monitorimi@dogana.gov.al

Drejtoria e Pronësisë Intelektuale

e-mail: ipr@dogana.gov.al

Për denoncime, numri pa pagesë: **0800 22 22**

